

Kumbona e së Diellës



KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT
Nr.5/6, Maj - Qershor 2017

KISHA NË SHQIPËRI FITON TRE BARIJ TË RINJ

Kisha Katolike në Shqipëri priti në festë tre ipeshkvijtë e rinj të emëruar nga Papa Françesku, Romë më 15 qershor 2017.

Për dioqezën e Sapës, Ati i Shenjtë Bergoglio emëroi ipeshkëv, administratorin aktual dioqezan, **don Simon Kulli**; për dioqezën e Rrëshenit, Papa emëroi ipeshkëv **don Gjergj Metën**, vikarin aktual të përgjithshëm të kryedioqezës së Tiranë-Durrësit; për Administraturën Apostolike të Jugut, u emërua ipeshkëv rregulltar barnabit, misionar në Milot, **atë Giovanni Peragine**. Plotësohet kështu një nevojë e ndjerë për udhëheqje shpirtërore në kishat përkatëse dioqezane, ku ipeshkvijtë aktualë kanë mbushur moshën e pensionit. Njoftimi i emërimit të ipeshkvijve të rinj u bë në orën 12.00 në Vatikan e po kështu edhe në selitë dioqezane përkatëse.

Nga emërimet e reja ipeshkëvnore vërehet se Kisha Katolike e Shqipërisë po kalon dalëngadalë në duart e thirrjeve të para vendase në meshtari. Dy prej ipeshkvijve të rinj janë pinjollë të asaj toke e Kishë, larë me gjakun e martirëve, fryti i të cilit tashmë është i dukshëm e mund të preket me dorë. Por edhe në figurën e ipeshkvit të ri të Jugut, vlerësohet lidhja e ngushtë e Kishës me misionarët e përkushtuar, për të cilët Shqipëria është bërë atdheu i dytë e vendi i bashkëpunimit në misionin e përbashkët të përhapjes së Lajmit të Mirë të Ungjillit në trevat shqiptare.

Që nga rënia e regjimit komunist e deri më sot, ringjallja e besimit dhe përforcimi i strukturave kishtare është realizuar duke u mbështetur në dy këmbë, duke marrë frymë me dy mushkëri, duke ecur me meshtarët e rregulltarët misionarë nga njëra anë, e me thirrjet vendase, nga ana tjetër; thirrje që kane mbijetuar persekutimin e diktaturës

e thirrje të reja, që tashmë janë bërë meshtarë të gatshëm për të marrë në duart e tyre fatet e Kishës në Shqipëri.

Ipeshkvijtë e rinj fillojnë tani një mision të veçantë e të shenjtë në krye të grigjës së Krishtit, detyrë, që deri tani, e kanë kryer me përkushtim tri figura, që kanë punuar me mish e me shpirt në vreshtin e Zotit. Nuk mund të mos kujtojmë ipeshkvin e ndjerë të Sapës, **imzot Lucian Avgustinin**, aq të dashur nga besimtarët, por edhe ipeshkvijtë, që tashmë dalin në pension: **imzot Hil Kabashi** për administraturën apostolike të Jugut dhe **imzot Cristoforo Palmieri** për dioqezën e Rrëshenit. Ata u dorëzojnë ipeshkvijve të rinj një thesar të çmueshëm shpirtëror, kishtar, shoqëror e kombëtar. Ky emërim nga Papa Françesku është bekim i mëtëjshëm për Kishën Katolike në Shqipëri, prandaj gjithë kleri e besimtarët falenderojnë Zotin për këtë dhuratë e për këtë shenjë kujdesi e dashurie ndaj kësaj Kishë vërtet të vogël, por të madhe, sepse i ka dhënë krishterimit mbarë shenjtore si Nënë Tereza e si 38 martirët e parë të lum të komunizmit.

Kisha Katolike në Shqipëri është për Papën Françesku periferi e dashur, e çmuar dhe e përkrahur në misionin e saj në shërbim të popullit e në lavdi të Zotit, nën shenjen e mëshirës e të përdëllimit, siç kërkon vetë Ati i Shenjtë Bergoglio nga gjithë ipeshkvijtë.

Si redaksi e programit shqip të Radio Vatikanit u bëjmë urimet më të mira të gjithë ipeshkvijve të rinj, por edhe të vjetërve, duke i falenderuar për punën e shkëlqyer në shërbim të Kishës e të kombit. Të gjithëve u jemi mirënjohës për intervistat dhe gatishmërinë ndaj programit tonë.





Papa Fraçesko TEOLOGJIA BËHET NË GJUNJË	4
Dom Gjovalin Simoni MARRËDHËNIET ME ATIN	5
Don Nosh Gjollaj TË MPOSHTEN KUNDËRSHTIMET	9
Dom Nikë Ukgjini ABAT PRENG DOÇI	12
Dom Lush Gjergji GHANDI	15
Benjamín GONZÁLEZ BUELTA S.I. PUSHTIMI I BOTËS DHE PUSHTIMI I ZOTIT	19
Gëzim Loka DOM NIKOLLË KAÇORRI	22
Prof dr. Edmond Malaj NJË HISTORI PËR KULTURËN SHQIPTARE	24
Fatmira Nikolli KUVENDI I TROSHANIT	26
Redaksia PTOLEMEU	27
Redaksia VITRINA E LIBRIT	28

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXXI, nr. 5/6 (495-496) Maj - Qershor 2017

Revistë
Fetaro-Kulturore
Drejtues
Imzot Angelo MASSAFRA

Redaksia
Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor)
Dom Artur Jaku
Dom Gjovalin Simoni

Adresa:
Arqipeshkvia Shkodër
Sheshi Gjon Pali II
Tel. 0222-42764
Fax. 0222-43673
e-mail: n_ukgjini@yahoo.it
Web page: kishakatolikeshkoder.com

Redaktor teknik: Xhon NIKA
Fotografe: Luli Ndreu

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

PAPA FRANÇESKU: VETËM ZEMRA E PËRVUAJTURE NJEH ZOTIN, TEOLOGJIA BËHET NË GJUNJË!

Kush studion misterin e Zotit të ulet në gjunjë, sepse Hyji ia zbulon vetveten vetëm zemrës së përvuajtur. Kështu pohoi Papa Françesku në homelinë e meshës së mëngjesit në Shtëpinë e Shën Martës.

Sytë e të varfërit janë më të përshtatshëm për të parë Krishtin e, përmes Tij, edhe fytyrën e Zotit. Të tjerët, që pretendojnë ta shqyrtojnë këtë mister vetëm me anë të inteligjencës, duhet të ulen në gjunjë e të jenë të përvuajtur, përndryshe nuk do të kuptojnë asgjë. Papa Françesku theksoi të vërtetën e paradoksin e misterit të Lajmit të Mirë: Mbretëria e Zotit u përket “të varfërve në shpirt”. Reflektimi i Atit të Shenjtë ndoqi pjesën e Ungjillit sipas Lukës, që na propozon sot liturgjia.

Krishti lavdëron e falenderon Atin Qiellor, sepse ua zbulon fytyrën atyre, të cilët as që llogariten nga shoqëria, ose atyre që, megjithëse të rëndësishëm, vendosin të bëhen “të vegjël” në shpirt: “Ai na bën ta njohim Atin, na bën ta njohim këtë jetë të brendshme, që Ai ka. E kujt ia zbulon këtë Ati? Kujt ia jep këtë hir? 'Të madhëroj, o Atë, Zotërues i qiellit e i tokës, pse ua fshehe këto të urtëve e të mençurve e ua zbulove të vegjëlve!' Vetëm ata që e kanë zemrën si të vegjlit, të aftë ta pranojnë këtë zbulesë me zemër të butë e të përvuajtur, që e ndjejnë nevojën për t'u lutur, për t'ia hapur zemrën Zotit, që ndjehen të varfër; vetëm ai që ecën në udhën e vet me Lumninë e parë: të varfërit në s h p i r t ... ”. Prandaj, varfëria është gjendje e privilegjuar për të hapur portat e misterit të Zotit. Një gjendje, që nganjëherë i m u n g o n pikërisht atij, i cili e studion me përkushtim këtë mister për gjithë jetën, nënvizoi Papa: “Shumë mund ta njohin shkencën, edhe teologjinë,

shumë! Por nëse nuk e bëjnë këtë teologji në gjunjë, pra me përvuajtëri, si të vegjlit, nuk do të kuptojnë asgjë. Do të na thonë shumë gjëra, por nuk do të kuptojnë asgjë. Vetëm kjo lloj varfërie është e aftë ta pranojë Zbulesën e Atit, përmes Jezusit. E Jezusi vjen, jo si kapiten, si ndonjë gjeneral ushtrie, si guvernator i fuqishëm, jo, jo. Vjen si filiz, si pinjoll. Kështu dëgjuam në Leximin e Parë: 'Një pinjoll do të dalë nga trugu i Jeseut'. Ai është pinjolli: është i përvuajtur, është i butë, erdhi për të përvuajturit e për të butët, për t'u sjellë shpëtim të sëmurve, të varfërve, të shtypurve”.

Jezusi, vazhdoi Papa Françesku, është i pari ndër të mënjauarit, i cili e konsideroi madje, vlerë të padiskutueshme “të qenit i njëjtë me Zotin”. Madhështia e misterit të Hyjit njihet vetëm në misterin e Jezusit, i cili përulet, përvuhet, zvogëlohet, por u sjell shëlbimin të varfërve, të sëmurve, mëkatarëve. Jashtë kësaj kornize, theksoi Ati i Shenjtë, nuk mund të kuptohet misteri i Jezusit:

“T'i lutemi Zotit, në këtë Kohë të Ardhjes, t'i afrohem gjithnjë e më tepër misterit të Tij e ta bëjmë këtë në rrugën, që Ai dëshiron ta bëjmë: rrugë e përvuajtërisë, rrugë e butësisë, rrugë e varfërisë, rrugë e atij, që e ndjen se është mëkatar. Kështu, Hyji vjen të na shpëtojë, të na çlirojë. Zoti na dhashtë këtë hir”.



Dom Gjovalin SIMONI
Shkodër

MARRËDHËNIET ME ATIN GJALLËROHEN VETËM NËPËRMJET LUTJES

(Liturgjia e Orëve, stola dhe mensa e përbashkët)
(Formimi permanent i klerit)

Të flasësh për situatën e priftave sot, nuk është aspak e lehtë sepse edhe ata janë pjesë e kësaj shoqërie në të cilën gjendemi të gjithë. Meshtari siç na kujton *Pastores dabo Vobis*, është marr nga populli dhe kthehet përsëri si prijës i popullit. Nëse është marrë nga populli nënkuptohet se është i përljer me të mirat dhe me të këqijat e popullit, ose më mirë me sensibilitetin dhe mënyrën e të arsyetuarit. Edhe pse ecja formative në seminar, kërkon që të bëhet një shqyrtim dhe një pastrim i mjaftueshëm për të qenë i denjë pastaj për shugurimin meshtarak, në të mbesin gjithsesi disa shenja që tregojnë përkatësinë e tij. Kjo na bën më realist dhe më vigjilent edhe për jetën tonë si meshtarë. Prandaj periudha e formimit ose e azhurnimit nuk duhet të mbarojë kurrë; me shugurimin meshtarak sapo ka filluar një ecje e re formimi ku teoria ka nevojë për një mbështetje reale dhe njerëzore për t'u bërë praktikë, ose për t'u mishëruar. Edhe më shumë, ka nevojë edhe për një që riparon nëse hapat e hedhur kanë lënë gjurmë jo të mira; në mënyrë që falë këtyre gjurmëve të kemi mundësinë dhe aftësinë për të pranuar gabimet dhe për të ecur përpara me guxim. Prandaj është e nevojshme një person konkret me të cilin ndahet buka e përditshme (com-pane= compagno), një shok, mik me të cilin ndajmë jo vetëm bukën por edhe sekretet e brendshme të jetës meshtarake (ndoshta në këtë pikë janë më të favorizuar rregulltarët falë stilit të jetës së tyre).

Meshtari sot jeton në një gjendje të turbullt dhe konfuze për shkak të një shoqërie që është gjithnjë e në ndryshim. Prandaj duhet që ai të rigjejë dhe ta rikuperojë identitetin që i është dhënë në shugurimin meshtarak. Ri zbulimi i rrënjëve meshtarake bën që të ringjallen në të shtyllat themelore që janë të qenit “njeri i Zotit” dhe njeri plot me zell në shërbimin e të tjerëve. Shpesh herë ritmi i shfrenuar i gjërave, puna e shumtë dhe stresi i akumuluar i ditës prodhojnë një farë “krize” e cila prek më së shumti stilin e jetës së meshtarit që shfaqet në aspektet e të qenit, të jetuarit ose më mirë të të lënit të vetës pas dore. Të jetosh atëherë në një klimë të tillë pasigurie dhe ankthi mund të shkaktojë një gjendje: “burnout”, e cila shfaqet si

një gjendje shqetësuese psiko-fizike që mund të shkaktohet nga mbingarkesa e punës dhe e angazhimeve ku personi arrin në një gjendje të “shterjes motive”; nuk ndien më asnjë dëshirë për punuar dhe për t'i bërë gjërat. Gjithçka i bëhet e rrafshët dhe e pakuptimtë. Kjo gjendje mund të lindin edhe fazën e parë të depresionit. Kjo sindromë godet më shumë ato persona që kanë të bëjnë me kujdesin ndaj të tjerëve, si: mësuesit, infermierët, edukatorët, priftat etj. Shpesh herë këta persona na duken si hije që ecin por pa shpirt, pa jetë dhe pa entuziazëm në punë e tyre. Fatkeqësisht edhe në Kishën tonë mund të ketë shenja të tilla, kjo jo për mos formimin e meshtarëve por edhe nga mbingarkesa ose mbivendosja e angazhimeve të ndryshme dhe në të njëjtën kohë. Prandaj, është e nevojshme një kujdes i vazhdueshëm ndaj vetes sonë, ndaj thirrjes sonë meshtarake dhe një qëndrim afër i njëri-tjetrit për të bërë të mundur mos rënien në këtë gjendje.

Prandaj kam dashur që sot me ju të bashkëndajë tre mundësi rritjeje nën moton simbolike të objekteve që i kemi me afër nesh çdo ditë dhe që shpesh nuk ua dimë vlerë: Breviari, Stola dhe Mensa e përbashkët, nën të cilat fshihen tre argumente thelbësore për jetën e një prifti siç janë: *Identiteti meshtarak*; *Shërbimi ndaj popullit të Zotit* dhe *Vëllazëria meshtarake*.

Identiteti meshtarak

Është e padiskutueshme atëherë që të punohet për të mbajtur gjallë vetëdijen meshtarake të dhuruar ditën e shugurimit meshtarak, duke rikuperuar kështu motivet themelore të thirrjes meshtarake: i thirrur për të qenë barë nën modelin e Bariut të Mirë, Jezusit të Nazaretit. Kjo vetëm nëse përpara ai qëndron me Të dhe pastaj edhe mund ta shpallë me jetën e vet (*krh* Mk 3,14). Duke qenë “njeri i Zotit” meshtari është i thirrur t'i përngajë çdo ditë e më shumë Krishtit për të vepruar pastaj *in persona Christi*, duke e gjallëruar kështu praninë e Krishtit në ditët tona. Prandaj është thelbësore lidhja kristologjike, sepse meshtaria e çdo prifti është e shartuar në meshtarinë e Krishtit, d.m.th, marrin pjesë në meshtarinë e Krishtit. Kjo mund të

na ndihmojë edhe neve që të ulim pak pritshmëritë tona që herë herë marrin forma fryrje të një gjithpushtetësie duke rrezikuar kështu që të lëmë jashtë Krishtin, Autorin që na ka dhuruar meshtarinë.

Duke u nisur nga kjo lidhje me Krishtin, ndihmohemi edhe ne të hyjmë në marrëdhënie me Atin, ashtu siç ishte në marrëdhënie edhe Jezusi me Të. Ky ishte edhe sekreti i jetës së Krishtit i cili ka përballuar çdo situatë dhe çdo vështirësi deri në braktisjen totale në duart e Atit edhe në kryq. Lutja

arsye kam dashur që nëpërmjet simbolit të Liturgjisë së orës ose Breviarit të shprehi këtë gjendje të vazhdueshme lutjeje meshtarake që është edhe lutja ndërmjetësuese e priftit për popullin e vet. Prandaj meshtari quhet me të drejtë “njeri lutjeje”, e kështu thirrej edhe nga tradita e popullit, sepse është kjo karakteristika thelbësore e jetës së tij. Nga lënie pas dore e lutjes burojnë të gjitha krizat e mundshme. Kështu studiuesi jezuit p. Luigi Rulla themeluesi i shkollës së psikologjisë në Gregorianë në statistikën e veta studimore pas



meshtarake e Ungjillit të Gjonit të kapitullit 17 tregon më së miri këtë lidhje të ngushtë mes tyre. *E gjithë kjo na bën edhe neve të hyjmë në të njëjtën lidhje me Atin nëpërmjet Krishtit.* Pjesa biblike e Gjonit 17 gjendet para mundimeve të Krishtit, d.m.th pas kryerjes së misionit baritor të Krishtit. Në këtë mënyrë qëndron një lidhje ekzistenciale mes Mk 3,14 dhe Gj 17. Në të shihet qartë lidhja e ngushtë e Krishtit me Atin në fillim, gjatë e në fund të misionit të tij. Besoj se kjo është limfa edhe për jetën tonë meshtarake. Njerëzit të fund të fundit na kërkojnë për këtë sepse presin nga ne diçka që bota nuk mund t'iu japë forcën prej qiellit. E kjo marrëdhënie me Atin nëpërmjet Krishtit Kryepriftit tonë gjallërohet vetëm nëpërmjet lutjes. Për këtë

konciliare të fenomenit të lënies së meshtarisë së shumë bashkëvëllezërve; rezultonte që 95% e tyre si motiv të para kishin braktisje e lutjes. Pastaj vinin edhe motivet tjera.

Jo vetëm lutja personale, ne e dimë se meshtari lutet e shenjtërohet edhe në lutjen me popullin e Zotit dhe në shërbimin që u bën atyre. Prandaj edhe vetë shërbimi i tij baritor bëhet një lutje e vazhdueshme edhe pse i vështirë bëhet fli e pëlqyeshme e Zotit. Kështu ai nëpërmjet shërbesës eukaristike të mirë kremtuar dhe të lutur ripërtërihet në atë që kremton. Mundohet që dita-ditës t'i përngjajë me jetë misterit që kremton.

Shën Karlo Borromeo e porositë klerin e tij me këto fjalë: “A e ushtron kujdesin për shpirtra?! Por

*mos e lë pas dore kujdesin për vetën tënde, dhe mos iu jep të tjerëve deri në pikën që mos të mbetet asgjë ty nga vetja jote. Duhet ta kesh parasysh kujtimin e shpirtit bariu i të cilëve je, por mos e harro vetveten. Kuptojeni, vëllezër se asgjë nuk është më e nevojshme për personat kishtarë se sa meditim që paraprin, shoqëron dhe përcjell çdo vepër tonën. Nëse mbarështon sakramentet, o vëlla, medito për atë që bën. Nëse e kremton meshën, medito për atë që po dhuron”. Meshtari nuk nxit vetëm të tjerët për rrëfim por rrëfëhet edhe vetë. Sepse kjo është në sintoni me atë që na thoshte Papa Pali VI: “Bota sot nuk ka nevojë për mësues por për dëshmitarë”. E do të jemi dëshmitarë vetëm kur ti besojmë atyre që u themi të tjerëve dhe ti jetojmë ne të parët. Prandaj lutja, kremtimi i Meshës, rrëfimi i vazhdueshëm bëhen kështu për ne meshtarët një limfë që e gjallëron identitetin tonë priftëror. Liturgjia e Orës, bëhet atëherë në kuptimin simbolik një *qendër njësimi* të gjithë aktivitetit tonë.*

Kam dëshirë që ta mbyll me një reflektim që bën një laik për identitetin e meshtarit sepse kështu ndodh disa herë që të tjerët na vlerësojmë më shumë se sa ne jemi të vetëdijshëm:

“Meshtarë, unë nuk jam prift dhe nuk kam qenë kurrë i denjë të bëhesha. Si është e mundur që edhe pas kremtimit të Meshës ju jetoni? Çdo ditë keni të Birin e Zotit nëpër duart tuaja; çdo ditë keni një fuqi të tillë që as Shën Mëhilli Kryeengjell nuk e ka? Me gojën tuaj ju shndërroni substancën e bukës në atë të Trupit të Krishtit; ju detyroni të Birin e Zotit të zbresë mbi lterë. Jeni të mëdhenj, jeni krijesa të pafundme; më të fuqishmit që mund të ekzistojnë. Meshtarë, ju përbelemi: jini të shenjtë. Nëse do të jeni të shenjtë ju, ne jemi të shpëtuar; nëse nuk jeni të shenjtë ju, ne rrezikojmë bjerrjen!” (Enrico Medi)

Shërbimi ndaj popullit të Zotit

Në fakt, Shën Pali kur flet për priftërinjtë parapëlqen të përdorë sinonimin “mbarështues” ose siç mund ta quajmë edhe ndryshe administrator edhe në gjuhën e sotme. Për këtë arsye ata përkufizohen nga ai si “shërbëtor të Krishtit dhe mbarështues të mistereve të Hyjit” (*krh 1 Kor 4,1*). Dëshiroj që në fillim ta theksoj këtë aspekt të rëndësishëm në lidhje me natyrën dhe misionin e vete meshtarit se në të kundërt është e vështirë të dilet nga logjika e sunduesit, ashtu siç ndodhi me bijtë e Zebedeut të cilët aspironin vendet e larta. Nëse keqformohet kjo logjikë edhe në mendjen e meshtarëve të rinj është e vështirë të pranohet

logjika e Darkës së Mbramë; d.m.th. ajo e shërbimit: “nuk erdha për të qenë shërbyer por që të shërbej e të jap jetën e time për të gjithë” (*krh Mk 10, 35-45*).

Prandaj edhe simbolika e Stolës që kam dashur të bashkëndajë me ju, ka pikërisht këtë domethënie, ajo e një logjike shërbimi me gëzim që shtyhet gjithmonë nga një ndjesi e të qenit të dashur aq shumë nga Zotëria sa nuk mund të qëndrosh duarkryq, por të shtyn që të veprosh: “Dashuria e Krishtit na nxit” (*2Kor 5,14*).

Nënkuptohet që meshtari gjatë ecjes formative të ketë pastruar disa skema tradicionale ose edhe klerikale të qenit një *pashà*, duke e pasur të vështirë të hyjë në logjikën e Krishtit shërbëtor. Mund të na ndihmojë atëherë vetëdija se meshtaria jonë nuk është pronë e jona por që ne jemi mbarështues ose më mirë shërbëtor të meshtarisë së Krishtit, dhe vetëm kjo do të ishte një nder për ne. Duke qenë se jemi pjesëmarrës të meshtarisë së Krishtit, atëherë mund ta na ndihmojë shumë fakti se edhe ne jemi barinj. Vetëm kur e mendojmë mirë thellë këtë dinjitet të qenit bari na mbush me përgjegjësi dhe afrimitet ndaj Jezusit, Bariut të mirë. Të mos e harrojmë këtë atëherë se jemi barinj, kjo do të na kthejë vetëdijen se përpara Zotit do të kemi ndjenjat e një bariu që i prin, e mbron dhe e kullot grigjën e vet.

Nga ana tjetër shpesh herë na thërrasin “atë” dhe në një farë mënyre jemi dhe duhet ta ndiejmë vetën ashtu. Ndoshta kjo na shton më shumë vetëdijes se vërtetë jemi *atë në fe*, sepse bëjmë që të rilindin prej së larti, ashtu siç i thotë Jezusi Nikodemit (*krh Gj 3,1-8*). Kjo është edhe trashëgimia jonë, jo një trashëgimi fiziologjike por shpirtërore. Nga ana tjetër për ne meshtarët e rinj mund ta krahasojmë veten si një vëlla i madh me të rinjtë që na rrethojnë. Janë të gjitha këto forma që na nxisin për t'i dashur të tjerët me një dashuri të pastër e familjare; ashtu siç jemi dashur falas e në mënyrë të drejtë nga vatrata tona familjare.

Zelli dhe dashuria baritore duhet të na shtyjë që të dalim nga komoditeti ynë. Ndoshta risia e Papa Françeskut është pikërisht se e ka filluar papatin e tij duke e nxitur Kishën të *dalë nga vetja*, nga komoditeti i vet dhe të shkojë drejt *periferive*. Në çdo vend ka periferi, në çdo rrethanë dhe marrëdhënie ka periferi. Prandaj nuk bëhet fjalë vetëm për një periferi gjeografike por edhe në marrëdhënie mes nesh; aty ku ka preferenca dhe simpati të ndryshme, mbetet gjithmonë dikush jashtë, i paragjykuar dhe i lënë pas dore. Ne e dimë

mirë ama se pedagogjia e Krishtit ishte pikërisht ajo e kundërta, sepse Ai kishte ardhur për të fundmit, për ata që në një farë mënyrë ishin të mënjanuarit e shoqërisë.

Duke u kthyer edhe një herë tek simbolika e “*stolës*”, dëshiroj që sa herë ta puthim atë para se ta vëmë në qafë të mendojmë pikërisht “*puthjen dhe dashurinë që tregojmë për shërbimin tonë ndaj të varfrit*”, edhe kur atë herë ky shërbim nuk është aspak i lehtë.

Vëllazëria meshtarake

Nën simbolin e *mensës së përbashkët* kam menduar të trajtoj një karakteristikë shumë interesante të jetës së meshtarit që vazhdimisht është lënë pas dore; bëhet fjalë pikërisht për *marrëdhëniet e shëndosha vëllazërore* që duhet të ekzistojnë mes pritave. Mensa e përbashkët është një *vlerë natyrore*, d.m.th se çdo njeri ka nevojë për një copë bukë. Por nga ana tjetër ajo mbanë në vetvete një vlerë të madhe shpirtërore dhe fetare sepse ne nuk ulemi në tavolinë vetëm për të ngrënë por edhe për të folur dhe për tu takuar me njëri-tjetrin mbi të gjitha. Duke pasur parasysh darkën shqiptare që vetëm me meze zgjaste disa orë, tregon se mikpritja ndaj mysafirit nuk ka për qëllim vetëm mbushjen e barkut por mbi të gjitha interesimi për jetesën, familjarët e gjënë e gjallë (bagëtitë). Kjo na mëson se si sofa e bukës merr një kuptim edhe biblik sepse na çon edhe tek Darka e Fundit në të cilën Jezusi themeloi meshtarinë dhe eukaristinë.

Shpesh herë ne bijtë e këtij shekulli dhe kulture po e humbasim fatkeqësisht këtë perlë të traditës shqiptare dhe biblike, qoftë në marrëdhënie me njerëzit qoftë edhe në marrëdhënie me njëri-tjetrin. Është shumë e dobishme të gjendemi në një tavolinë për të ngrënë por mbi të gjitha për tu parë në sy, me gjithë lodhjen, vështirësitë por edhe gëzimet e një baritore që në fund të fundit të gjithë jemi pjesëtar të një vreshti të Zotit.

Nëpërmjet mensës së përbashkët kam dashur të nënvizoj nga njëra anë vlerësimin e aspekteve njerëzore, d.m.th vëllazërinë, njerzillëkun, mirësjelljen qoftë me Ipeshkvin por edhe me njëri-tjetrin. Unë mendoj se nga që jemi trashëgimtarë të një sistemi totalitarist kjo gjë ka sjell pak dëme në marrëdhëniet e drejta me autoritetin, por nga na tjetër këto marrëdhënie janë të plagosura edhe në botën perëndimore, me figurën e babait. Kjo gjë shpesh herë edhe në mënyrë të pavetëdijshme ndikon në marrëdhëniet tona meshtarake dhe kishtarake.

Është e rëndësishme atëherë se para se të hyjmë në marrëdhënie pune ose vetëm baritore të mos humbasin qasjen njerëzore të marrëdhënieve; d.m.th kujdesin njerëzor, shëndetësor dhe vëllazëror qoftë me ipeshkvin apo edhe me njëri-tjetrin. Ndoshta kthimi në qendër të interesit njerëzor do të shuaj shumë konflikte dhe tjetri nuk do të shihet vetëm si rival por si një vëlla që ka dobësi, të meta dhe ka nevojë për mua. Prandaj dreka ose darka, kafeja ose qëndrimi sëbashku bëhet mundësi e artë për të treguar dashuri njerëzore dhe vëllazërore. Nga ana tjetër të kërkojmë që mos të biem në nivele të ultë darkash që jo vetëm nuk del në pah ndihma vëllazërore por bëhet edhe darkë tradhtie, sepse vetëm flitet keq për njëri-tjetrin dhe bëhemi shpallës të së keqes dhe shokë të “akuzuesit” i cili veç flet keq për ne.

Ndoshta mund të duket argumenti më i pavlerë dhe i fundit në trajtimin e temës por për mua është çelësi i zhbllokimit të shumë situatave dhe ngërçi edhe mes nesh si meshtarë. Në fund të fundit rreth një tavoline jemi rritur dhe me ngrohtësinë e marrëdhënieve njerëzore jemi ushqyer. Prandaj le të kultivojmë këtë aspekt njerëzor të qëndruarit afër njëri – tjetrit pa paragjykime. Ta bëjmë çmos që të mos mbretërojnë mes nesh thashethemet, ose siç i quan Papa Françesku: terrorizmi i thashethemeve, por të jemi vërtete përçues të Lajmit të Mirë.



Don Nosh GJOLAJ
Podgoricë

TË MPOSHTEN TË GJITHA KUNDËRSHTIMET

(Pjesa e dytë)

2. Çka do të bëj, po qe se më ndodh mua një sëmundje e papritur?

Një mjek thotë: "Më mirë është që të ndërpriten fjalët e shumta, që zakonisht i përdorin për ta mësuar e për ta këshilluar njëri-tjetrin, qoftë për ilaçe qoftë për mënyrën e shërimit. Por është shumë më e nevojshëm dashuria dhe vëmendja ndaj pacientit!"

Çdo njeri i pjekur dhe i arsyeshëm, në mes të tjerash mediton edhe për te papriturën, qoftë nga sfera e sëmundjes, qoftë nga trafiku i përditshëm, sepse ai është gjithherë i përgatitur jo vetëm fizikisht por edhe shpirtërisht për çfarëdo sëmundje që mund ta rrok. Një përgatitje e tillë është e mirë edhe për çiftin martesor si në fushën emocionale ashtu edhe në atë psikike dhe shpirtërore. Njeriu duhet të jetë gjithherë dhe kurdoherë i gatshëm për çfarëdo te papriture apo sëmundje që mund eventualisht ta rrëmbejnë. Nuk është fjala vetëm për sëmundje fizike, por edhe ato psikike, e fiziko-psike ose psikosomatike.

Çifti martesor duhet të vetëdijesohet se partneri i sëmurë është jo vetëm i ngarkuar por edhe i ndjeshëm, i prekshëm, i padurueshëm, i paafte për

dialog apo bisedë që në rastet e tilla nuk ftohet në tryeze për t'i zgjedhur problemet. Por në rastet e tilla duhet të armatosen me durim e tolerancë për ta realizuar dashurinë e përherëshme. Sepse, si për njërin ashtu edhe për tjetrin e kanë të drejtën për realizimin e dashurisë e të fat lumturisë. Kuptohet njeriu normal nuk dëshiron sëmundjen dhe as nuk strehohet në sëmundje, por është dëshira e tij për të qenë i shëndoshë. Në rastet e këtilla më tepër fletë gjuha e zemrës se sa gjuha e arsyes së mendjes. Ja një shembull:

"Klara shkoi në spital për të lind frytin e dashurisë. Ishte mjaft e emocionuar që e shoqëronin në njërën anë befasia dhe në tjetrën anë frika. Befasia e saj ishte, se asgjë nuk ndodhi ashtu siç e ka paramenduar, asgjë nuk u realizua për ata që i patë thënë mjeku në kohën e shtatzënisë (që ia patë sugjeruar abortin, sepse sipas mjekut: fëmija do të lind i sëmurë ose me ndonjë defekt). Frika, në anë tjetër e shoqëron një farë përgjegjësie e madhe, që filloi të lëkundet, se nuk do të mund të ballafaqohet me realitetin. Presioni është edhe më i madh që ia ngarkon mjeku (gjinjekologu) dhe infermiera, të cilët jo vetëm se nuk i ndihmojnë për ta pranuar realitetin - frytin e dashurisë ashtu siç është, por edhe e fajësojnë për gjestin, që ajo ndërmori për ta lindë fëmijën. Presionin është mjaft i ngarkuar në veçanti moralisht, që e ngarkon mjedisi, e cila pa ndërpre i dëgjon fjalët që i drejtohen asaj direkt: 'Për ty do të ishte më mirë, po qe se pranon abortin!' ose 'Mos krijo ndonjë iluzion, situatën nuk mund ta përmirësosh!' etj. Në vend që mjedisit të jetë shtylla e kurajës, në këtë rast e ngarkon, e fajëson Klaren në fjalë, e cila gjendet në dy luftime: me botën e jashtme dhe me pikëpamjet e veta etiko-morale, menjë fjalë, luftë në dy fronte. Por lindi fëmija, e cila ishte vajzë, po ashtu ajo ishte krejtësisht tjetër për të cilën e ka imagjinuar. Por asaj duhet për t'i ndihmuar e për t'u kujdesuar bile edhe më tepër, por në momentet kritike thuajse nuk mund të llogarisë në ndihmën e askujt, por gatishmërinë për t'u përballuar edhe kundërshtimet e fajësimet që i drejtohen në rastin tonë Klarës.

Në këtë rast i ka ndihmuar shumë besimi në Zotin, sepse ishte shumë vështirë për të thënë: 'U bëftë vullnesa jote'. Besimi ishte ajo që jo vetëm që e jep kurajë, por ia çeli apo hapi zemrën e shpresës dhe të besnikërisë.

Problemi mbetet edhe më tutje, si do ta pranojnë



këtë fëmijë mjedisit në të cilin do të rritet e zhvillohet...?”

Sido qoftë e rëndësishme është jo vetëm dëshmia e zemrës, e cila depërton në thellësitë e njeriut, por edhe dinjiteti e krenaria e njeriut, i cili e realizon dashurinë. Dashuria gjithherë e kurdoherë është e gatshme për ta asgjësuar ose lehtësuar vuajtjet, dhimbjet apo mërzinë. Në këtë rast dashuria e pjekur është njëherë edhe edukatorja e jetës që i sjellë fatlumturin e gjatë në bashkësinë martesore.

3. Hape derën e zemrës!

Shumica e çifteve të reja janë sot në vështirësitë, jo vetëm fizike por edhe sociale, materiale e shpirtërore, dhe si të tillë jeta e përbashkët është mjaft e ngarkuar mos të themi e koklavitur. Rugëdalja nga bota e sotme që është mjaft dinamike, është në takimin edhe me çiftet tjera që përjetojnë pothuajse të njëjtin problem, qoftë ai i përshtatjes së rrethit, qoftë ai i vuajtjeve të brendshme, qoftë ai i mosrealizimit të ëndrrave të jetës në bashkësinë martesore. Po qe se çifti në fjalë i ka edhe fëmijët, atëherë problemet, mos marrëveshjet e komplikojnë edhe më tepër. Kuptohet njeriu gjithherë dhe kurdoherë duhet të ketë miq, shokë, njerëzit e besueshëm me të cilët mund të diskutohet, t'i hapet dera e zemrës. Në rastin tonë u preferohet partnerëve të njëjtës moshë, si fjala bie, po qe se kanë fëmijën, atëherë të shoqërohen me ata çiftet që i kanë fëmijën të njëjtës moshë. Nëpër mes të takimit me tjerët jo vetëm se shfryhemi por edhe entuziazmohen, për rrugën në të cilën gjendet çifti martesor, po ashtu edhe fëmija jo vetëm se argëtohen por edhe socializohen me moshataret e vet.

Sot është mjaft e theksuar edhe mospërshtatja e mjedisit në të cilin jetojmë, posaçërisht në qytetet e mëdha, ku njeriu ka mbetur anonin pranë morisë së madhe të njerëzve që lëvizin njëri për krah tjetrit si kufoma të gjalla, por fatkeqësisht: jemi njëri për tjetrin të huaj, të largët, të panjohur mos të themi të ftohtë. Atëherë nuk është për t'u habitur pse njeriu i sotëm vuan nga vetmia. Për këtë është edhe një vetëdijesim i ri, që çifti martesor duhet ta kapërcejë këtë sfidë, sepse në të qëndron një përgjegjësi e madhe. Te çiftet që janë nga natyra tipit të çelur apo ekstravert, nuk paraqet ndonjë problem, për të krijuar urat edhe me çiftet tjera, por më tepër vlen për tipin e tërhequr të tipit introvert, i cili është i mbyllur. Në rastet e tilla, u këshillohet çifteve, ta shfrytëzojnë kohën e lirë për të dalë për të vizituar jo vetëm familjen e ngushtë, por edhe fqinjët, që të interesohen për tjetrin, e t'i shohin edhe hallet e tjetrit dhe mënyrën se si ata i kapërcejnë, jo vetëm

çështjet ekonomike, por edhe hallet e brendshme çfarëdo dhembjeprurëse se si i tejkalojnë.

Përpos kontakteve me prindërit, apo me gjirin familjar ose me shokët, është mirë edhe kontaktet e shpeshta edhe me entet, si për shembull me shkollën, me bashkësinë e famullisë, kyçja qoftë në korin e kishës apo ndonjë organizatë tjetër humanitare etj. Sipas hulumtimeve të bëra nga Raporto Faure, shihet se si kyçja e njerëzve në mënyrë për t'i zgjedhur problemet e mjedisit apo të rrethit, jo vetëm se u sjellin sukses shoqërisë por edhe fatlumturin individuale, sepse çdo individ e përjeton angazhimin në mënyrë pozitive dhe si i tillë jo vetëm se i zgjedh problemet apo hallet e tjetrit por edhe të vetat.

Në rendin e parë është e ftuar familja, që të kyçet së bashku me veprimtarin e shkollës, sepse prindit nuk do të mund të jenë te suksesshëm po qe se nuk arsimohen në mënyrë permanente me shkollën e sotme, për t'i edukuar e për të qenë i gatshëm për t'u përgjigj kërkesave të brendshme të fëmijës që ia imponon koha e sotme. Ashtu jo vetëm se shkolla dhe prindit janë solidar duke i ndihmuar njëri-tjetrit, por edhe njëherë edhe kontribuojnë për zgjedhjet e problemeve, halleve të llojllojshme që i sjellë jeta e përditshme. Po ashtu edhe kyçja në bashkësinë famullitare ose angazhimi i shpeshtë në seksionet e llojllojshme, që zhvillohen në oborrin e kishës, si për shembull seminarët e llojllojshme, takimet e shpeshta çifteve mes vetes që mbahen temat e caktuara nga njerëzit specialist, ushtrimet shpirtërore qoftë në famulli qoftë jashtë saj, apo çfarëdo angazhimit tjetër janë te mirëseardhur për çdo çift martesor. Sepse angazhimet e tilla jo vetëm se e zvogëlojnë tjetërsimin e individit apo e zbehin dhembjeprurëset, por edhe shtëpia e tyre bëhet vendtakim i gjallë, në të cilën diskutohen temat e problemet e jetës së përditshme, që ia sjellë dinamika e ditës, po ashtu shkëmbehet jo vetëm ideja e llojllojshme, mos të themi mënyra e zgjedhjeve jo vetëm konflikteve të përditshme por edhe vështirësive konkrete, që dita-ditës i shkaktajnë kokëçarje jo vetëm çiftit por edhe mjedisit apo vendit më të gjerë, por edhe shkëmbimi i përvojave.

Suksesi nuk do të mungojnë as në rrafshin social, që do të thonë solidariteti me tjetrin, qoftë në vijën materiale - ekonomike, qoftë në vijën shpirtërore apo kulturore, as në rrafshin e brendshme shpirtëror, jo vetëm se ia lehtëson brengat, hallet, dhimbjet por edhe mundësia për t'i tejkaluar, e për t'ia krijuar vetes e tjetrit fatlumturin e afatgjatë. Për këtë mendësi është e domosdoshme hapja e zemrës ndaj tjetrit. Njeriu është qenie sociale, i cili jeton me

tjetrin e përkaj tjetrit, e solidariteti atë jo vetëm se e ngrit, por me fuqitë e përbashkëta më lehtë i kundërvihen çfarëdo problemit apo vështirësive, që e sulmon bashkësinë martesore!

4. Dy qëllime duhet t'i realizojnë njeriu i ri

Njeriu i ri, duhet më së pari ta formoje identitetin e fortë, zakonisht identiteti formohet në fazën e adoleshencës, që është njëherë edhe pjekuria fizike e biologjike e njeriut, i cili vetëdijësohet për përgjegjësin e jetës edhe ndaj tjetrit. Baraspesha që njeriu duhet t'ia arrin në këtë moshë e quajmë edhe ndryshe tërësia e brendshme apo identiteti. Përpara se njeriu i ri arrin deri në këtë pikë, ai duhet t'i kalojnë të gjitha fazat e deritanishme të fëmijërisë, sepse, e reja fillon të endet, që duhet të dijë të dallojë, se çka ai mendon për vete dhe çka të tjerët mendojnë për të. Nga aspekti konkret të personit është i tërësishëm, diçka më tepër se sa shuma e gjitha risive të viteve të mëhershme, siç fjala bie, ai si fëmijë ka dëshiruar të bëhet dikush, por ishte i detyruar të punonte, siç kanë kërkuar të tjerët prej tij, posaçërisht prindit apo shkolla.

Monoliteti i brendshëm që nuk është tjetër përveç se një copë e vetme, e pandarë e madhe, që përbën një masë të vetme, të pandashme e të fortë, që është një trup i vetëm ose në mënyrë figurative që përbën një të tërë të vetme, që është si një trup i vetëm e i pandashëm, i bashkuar fort. Pikërisht ky monoliteti i adoleshentit bie në krizë, që është e mundshme të zgjidhet duke imituar bashkë kohanikët e tij gjeneratë dhe personit të fort, që janë jashtë rrethit të familjes. Ai duhet pa ndërpre që këtë monolit të brendshme në mënyrë të përhershme, ta ripërtërijë që nuk është e mundur pa dhimbjet e vogla apo të mëdha. Kërkimi qëndrimeve apo të pikëpamjeve të jetës zhvillohen në verifikimin e përhershme, po ashtu edhe mundësit e reja duke krahasuar me ato qëndrimet e vjetra, vetëm për vete për t'ia arrite atyre vlerave e drejta. Kuptohet se ndikon mjaft mjedisi apo rrethi, e në anë tjetër dëshirat që ia vështirëson përcaktimin e drejtë, nganjëherë edhe mjegullohet apo hutohet për t'i pranuar rolet e llojllojshme të jetës, sepse tinxheri apo adoleshenti është në mënyrë permanent në fazën e jo baraspeshës, me një fjalë është i ndarë në mes dëshirave apo ëndrrave dhe kërkesave të mjedisit, që kërkojnë nga ai, për këtë nuk është i aftë për të arritur deri te qëndrimet e shëndoshtë e të kthjelltë, sa i përket pikëpamjeve etiko-morale, seksuale, profesionit dhe kërkesave tipologjike, zakonisht vendos vetëm për një gjë, që e prano si të vetmen.

Kur flasim për monolitetin e brendshëm shpeshherë e përdorim shprehjet siç janë “integriteti” dhe “totalitarizmin”. Në mes tyre ka dallime të mëdha.

“Integriteti” që nuk është asgjë tjetër përveç tërësia e pandarë e të paprekshme. Tërësia e gjërave të llojllojshme, që i kuptojmë në mënyrë të ndryshme por në fazën përfundimtare janë monolite që krijojnë një tërësi të pandashme. Fjala është për programimin e mirë e ndikimi i përhershëm në funksionet të njëjtit trup, të cilave është kufiri gjithëherë i çelur dhe i lëvizshëm.

Përderisa “totalitarizmi” që nuk është asgjë tjetër përveç pushteti në të gjitha fushat e jetës. Me fjalë tjera është i pranishëm kufiri absolut: atëherë kurë përcaktohem i nuk bënë të mbesin asgjë jashtë përcaktimit, po ashtu nuk bënë të mbesin asgjë nga ana e jashtme që duhet të jetën në përcaktimin e definuar. Është fjala për mbudhje absolute e radikale, që i përjashton të gjitha ato që dalin nga fakti, që janë pjesët të cilat duhen të bëhen absolute, që mes vetes i kanë apo e kanë një farë lidhje të qartë, janë mes vetes të lidhur ose nuk janë.

Ata çka dëshirojmë për të thënë, është nevoja psikologjike apo psikike e njeriut për totalitarizëm, e cili kishte për t'i përjashtuar të gjitha mundësitë e zgjedhjes, edhe pse e refuzon çfarëdo tentimit për integritet. Shkurtimisht, kur individi për çështjet e mungesës për të menduar ose është ende i pazhvilluar mirë, qoftë fizikisht, qoftë biologjik, qoftë psikik, ai e humbë integritetin dhe mund ta ripërtëri vetveten dhe mjedisin vetëm atëherë kur vendos për përcaktimin totalitar.

Për ndryshe çifti që nuk është i përcaktuar, dhe as nuk e ka definuar mirë jetën në bashkësinë martesore, ende nuk është i pjekur për një jetë që kërkon jo vetëm përgjegjësi, por edhe aftësi, qofshin ato emocionale apo afektive, qofshin ato mendore apo psikike për të jetuar me tjetrin, për t'u përshtat mjedisit e njëherë për ta ruajtur identitetin e pacenuar, po ashtu nuk i cenohet as tjetrit identiteti!



Dom Nike Ukgjini
Shkodër

ABBAT PRENG DOÇI, PËR GJALLËRIMIN DHE LULËZIMIN E SHQIPËRISË

Abat Preng Doçi
7 shkurt 1846 – 22 shkurt 1917
(Pjesa e parë)

(Konferencë përkujtimore, “Gjurmime Albanologjike” organizuar dt. 2. Qershor 2017, nga Universiteti i Shkodrës).

Krahina mesjetare e Mirditës, ka një histori të bujshme dhe shumë kureshtare. Si mbiemër ndeshte për të paren herë në kadastrën Venedikase të Shkodrës të vitit 1416-1417, në personin Gjon e Pjeter Mirdita. Ndërsa Mirditën si fshat apo krahinë mirë të organizuar e gjejmë në regjistrat osmane të Sanxhakut të Dukagjinit të vitit 1533, 1571 etj. Historia e kësaj krahine legjendare pa dyshim lidhet ngushtë me zhvillimet kishtarë, kulturore e politike, dioqezës së Arbrit të shek..XII - (Sancti Alexandri diocesis Albanensis), pikërisht abacie benediktine që funksiononin brenda shtrirjes së saj gjeografike, si: abacia e Shën Palit në Blinishtin e Vjetër, e Shën Marisë në Nderfanë, e Shelbuemit në Rubik, e në veçanti të abacisë së Shën Llezhdrit në Orosh të Mirditës, e cila qe epiqendra e më e rëndësishme që lidhet ngushtë me ngjarjet historike të pushtimeve në harkun pesë shekullor (1468-1912) të gjysmë hënës turke mbi Mirditën dhe trojet shqiptare në përgjithësi.

Abacia së Shen Llezhdrit në Malin e Shenjtë të Oroshit (Agjios Oros), e themeluar në vitin 1319 dhe cila lidhet ngushtë me jetën dhe veprimtarin e abat Preng Doçit (1646-1917), gjatë kohës se pushtimeve të egra osmane ishte një vatër e zjarret shpirtërore, morale e politike. Ajo qe shtylla më e fort dhe faktor i rëndësishëm për mos helenizimin e mos turqizmin e shqiptarëve në Mirdite e më gjerë. Abacia e Oroshit, gjatë shekullit të XVIII, shërbeu si vend hapësirë për krijimin e unitetit të besës të 5 apo 12 bajraqeve të Mirditës, ashtu edhe në mënyrë te veçantë me krahinat fqinjë, si Malësi e Madhe, Mat, Dibër e Lumë, në përballje me pushtuesin aziatik i cili kishte për qëllim nënshtrimin e kësaj



krahine e për ta vazhduar aksionin në përmbysjen e plotë në krahinave të tjera në veri të Shqipërisë. Qeveria Turke, kërkonte futjen në përdorim të sheriatit (ligjit kuranor) duke zëvendësuar Kanunin e Maleve, ku kjo e fundit ishte idea më e spikatur e shpirtit të shqiptarit, për ruajtjen e lidhjes nder fisnore, besës, mikpritjes, ndihmesës së tjetrit në rast ngushtice, kultivimin e ndërgjegjejes kombëtare etj.. Katolicizmi duke qenë vlere universale dhe komunikim shpirtërore i njerizimit dhe shkollë e ideve të qytetërimit evropian u ndje fuqishme në altarin e kulturës dhe identitetit tonë

kombëtar në Arbëri, por në veçanti në krahinën e Mirditës, ku pushtuesi aziatik krijonte kurthe të veçanta shkatërrimi për nënshtrimin e islamizimin e kësaj krahine të ashpër e të paepur e legjendare.

Brumosja e Doçit


Secilit shekull, besimtarët mirditas dhe prelat të tyre i rezervojnë ngjarje me rendësi në përpjekjet për forcimin e katolicizmit dhe theksimi e tipareve kombëtare të tij. Në përballje më pushtuesin turk në gjysmën e dytë të shekullit XIX, spikaste, dom Preng Doçi, i lindur më 7 shkurt vitit 1846, në lagjen e Parasporit, në luginën më të bukur të Bulgrit të Mirditës. Prenga, i nxitur nga ipeshkvi i Lezhës, atdhetari Pal Dodmazej dhe klerikët atdhetar të abacisë së Oroshit si, poeti i njohur Dom Pjeter Zarishi dhe Dom Gasper Krasniqi, duke fituar thirrjen e meshtarisë, përfundoi mësimet e mesme klerikale në Seminarin e Jezuiteve në Shkodër, (1859-1861) për t'i vazhduar studimet e larta filozofike e teologjike në kolegjin Urbaniano të Romës të cilat i përfundoi me mjaft sukses në vitin 1871.

Gjatë qëndrimit në Romë ai krahas lendeve të shkollës u njoh edhe më gjuhen e letërsinë arbëreshe dhe poetin e madh Jeronim De Rada e Dimiter Kamarda dhe më disa vepra të njohura deri atëherë të shkrimtarëve tanë të vjetër, nga të cilat thelloj dijeni shpirtërore letrare e atdhetare.

Dochi, gjatë pasurimit më dituri në Romë, krahas shqetësimit për gjendjen shpirtërore të popullit në Arbëri, në vëmendjen e tij vazhdimisht ishte gjendja e vështirë e mirditasve e mbajtur si “ishull” nga shtetrrëthimet turke.

Nga mërgimi ëndrra për vendlindjen


Dom Preng Dochi, i frymëzuar qysh në fillim të rinisë së vet me idenë e thjeshtë atdhetare, sapo shkeli në tokën e të parëve, në Mirditë, në vitin 1871, për shkak të trysnive të vazhdueshme të pushtuesve, krahas për kujdesit shpirtëror të besimtarëve në Korthpulë e më vonë në Abacinë e Oroshit, u dha intensivisht pas çështjes kombëtare. Në fillim si kapelan dhe sekretar tek Abati i Oroshit, dom Gasper Krasniqi gjatë viteve 1872-1875 dhe më vonë si famullitar në Kalivare rrëzë mali të Mëneles, kohë e cila lidhet me kryengritjet kundër turqve të viteve 1876-1877, ku Doçi luajti një rol të dorës se parë i ndihmuar nga princi i Mirditës,



Preng Bibë Doda.

Pas helmit të Bid Dodes dhe të ipeshkvit Pal Dodmazein në vitin 1868, nga Perandoria Osmane dhe dështimit të kryengritjes në prill të vitit 1877, situata në Mirditë si vatër e fuqishme qëndresë Shqiptare, shkoi duke i keqësuar dhe dita ditës kuptohej se do kalonte në shpërthim me armë. Për t'ia bërë të njohur Evropës situatën alarmuese, në maji po të këtij vitit, Dom Preng Doçi do të dilte jashtë kufijve të Perandorisë. Duke kaluar neper shtigje malore nga Shkreli, Boga e Thethi, rruga e tij që e shkurtër sepse në kufirin me Malin e Zi në Andrijevicë afër Plavës dhe Gucisë, u zu robër nga usharet Turq dhe prej andej e dërguan në Pejë dhe në fund në Stamboll të Turqisë. Nga ky vend rinisi për Preng Doçin 31 vjeçar, në jetë e re me plotë sprovë neper tre kontinente: Evropë, Azi e Amerikë, që do zgjaste plot 11 vjet.

Pasi u dërgua në burgun e Stambollit, Doçi arriti të kontaktojë me patriarkun katolik të këtij kryeqyteti, armenin Stefan Azarjan, i cili sapo u



njoftua për këtë çështje, ndërmori aksionin për ta liruar dom Prengën. Patriarku, fal zgjuarsisë së tij diplomatike arriti për ta liruar nga burgu Dochin, më emrin *Père Achile*, me kusht që të mos kthehej në Shqipëri. Doçi, më zemër të thyer më 7.VII. 1877, nga Roma iu dashtë të nisje në mision të ri në Tokën e Re, (New Foundland), duke u shënuar si emigranti i parë shqiptarë në Amerikë.

Pas punës misionare për shumë vite në Gjirit e Ishujve në Kanada, nga letra e Doçit mësojmë së më 2 prill 1883 është në Romë, dhe më 16 maj 1883, zbrit në portin e Tivarit pasi gjoja kishte marrë të dhëna prej Shkodrës së asgjë nuk do i pengonte për kthimin e tij në Shqipëri. Por, pasi përpjekjet e ipeshkvit të Shkodrës, Imzot Guerrinit dhe autoriteteve diplomatike në Cetinë nuk sollën rezultatin e duhur, për kthimin e tij në Mirditë, Doçi ishte kthye në Romë, dhe më porosi të Propaganda Fides, në gusht 1884, mori përsëri rrugën e mërgimit tashmë për në Indin e lart në Bombei, ku qëndroi deri në vitin 1886, për tu kthye po në këtë vit përsëri në Romë.

Doçi, më kulturë të gjerë e vërtetuese i vëmendshëm gjatë qëndrimit në mërgim, u thellua në njohjen e botës të popujve të jetës e të kulturës të mënyrës së tyre të qeverisjes.

Prandaj është në vend të theksohet së kjo periudhë e qëndrimit të tij në Kanada e Indi e me pas në Romë, ka ushtruar një ndikim të madh në formimin e tij duke u bërë kështu një nga personat më të shëtitur e më të ditur të kohës së tij. Ai pasuroi në mënyrë të gjithanshme teorike e praktike dijen e provojën

e vet në fushën e luftës politike dhe organizimin e luftës për liri dhe në lëmin e kulturës dhe besimit katolik.

Doçi edhe nga Bombei i largët, por edhe nga Roma e afërte, mbante lidhjet me atdhetarë shqiptarë, jetonte me brengat e atdheut të vet. Në pritje të përgatitjes së terrenit për kthimin në vendlindje, Doçi në Romë beri disa hulumtime nëpër arkiva e biblioteka të Vatikanit duke gjurmuar materiale për Shqipërinë e në veçanti për vjetërsinë e Mirditës dhe abacisë së Oroshit. Me këto materiale historike paraqiti Mirditën si princer autonom. Më shumë dëshmi historike e këmbëngulje arriti t'ia mbushi mendjen Selisë së Shenjte, që abacia e Oroshit, me

dekretin “supra montem Mirditarum”, Papa Leoni i XII datë 25 tetor 1888, të njihet si abaci e një rangu të veçantë me titullin “Abacia Nullius”, që ishte e rangut të një dioqeze e cila nuk jep llogari asnjë ipeshkvi, por drejtpërsëdrejti Selisë së Shenjte.



Dom Lush Gjergji
Prishtinë


MOHANDAS KARAMCHAND GANDHI (1869 – 1948)

(Pjesa e parë)

„Gjithçka dëshironi t'ju bëjnë juve njerëzit, bëni edhe ju atyre! Ja, vërtetë Ligji e Profetët!“ (Mt 7, 12)

„Dashuria është forca më e njohur dhe më e madhe që e ka bota... Nëse më duhet të vdes nga goditjet e ndonjë të çmenduri, këtë do e bëja me buzëqeshje. Hyji do jetë në zemrën dhe buzët e mia... Jodhunë është ti duash ata që na urrejnë. E di që kjo është e vështirë... Krishti është burimi më i madh i fuqisë së njeriut...“

Mohandas K. Gandhi



Mohandas Karamchand Gandhi, u lind në Porbanadar në gadishullin Kathiawar, më 2 tetor 1869, nga prindërit Karamchanda dhe Putlibai Gandhi. Ati Karamchand ishte kryetar i këtij gadishulli, kurse e ëma e tij Putlibai ishte grua e thjeshtë, sot do të thuhej amvise. Para Mohandasit, ata kishin tre djem. I ati, ishte shumë energjik, diktator ndaj bijve dhe gruas, sillej si zot absolut i të gjithave. Nëna ishte e nënshtruar, grua e qetë dhe përshtypshme, shpesh lutej dhe agjëronte shumë.

Mohandas Karamchand Gandhi, i quajtur me plotë të drejtë Mahatma – Shpirti i Madh, që nga

rinia e hershme kërkoi të Vërtetën në Dashuri, krijoi dhe zbatoi vazhdimisht dhe trimërisht strategjinë jodhunore. Ai shpeshherë thoshte: „Ti frikohemi Zotit që më s’i frikohemi njeriut.“

Që në rrethin familjar, duhesh ta mësosh disiplinën, rregullin, por edhe padrejtësinë ndaj shtresës më të ulët “parisë“, të cilët konsideroheshin të papastër, pra, ishin të përjashtuar nga gjitha marrëdhëniet ndërnjerëzore, nga marrëdhëniet me shtresa dhe njerëz tjerë. Ishin të lindur dhe të dënuar për të jetuar dhe vdekur si skllevër.

Mohandas qysh si fëmijë që nga mosha 10 – 12 vjeçare pati dëshirë të komunikonte me këta të „papastër“, me këtë botë të paprekshme, me një pastrues që quhej Uka, si dhe të birin e tij.

Nëna Putlibai, ia tërhoqi vërejtjen shumë ashpër për këtë gjest të pazakonshëm, të turpshëm dhe ndaluar, të rrezikshëm për njollosjen e shpirtit!

Mirëpo, vogëlushi Mohandas-i mendoi në vete kështu: Edhe ata janë njerëz sikur ne. E dimë se janë të „papastër“, të përjashtuar, mirëpo për mua nuk është e rëndësishme kjo traditë e pakuptimtë!

Këtë pamje ai do ta bartte në kujtesë dhe në shpirt gjatë tërë jetës, por edhe do luftojë me të gjitha forcat për rrënimin e pengesave dhe paragjytimeve në mes shtresave hindu.

„Si është kështu që pariet (shtresat e ulëta) të jenë të papastra, të paprekshme, aq sa bile edhe hija e tyre mund t'i infektojë shtresat tjera?“ do pyetet Gandhi.

Ky ishte kuptimi dhe bindja fetare e brahmanëve, një ndër shtresat priftërore hinduse. Nga kjo përvojë i madhi Gandhi do vijë deri tek përfundimi i guximshëm: *„Këtë paprekshmëri e konsideroj njollën më të madhe të hinduizmit!“*

Mohandas Gandhi si fëmijë u rrit normalisht, sikur edhe shumë bashkëmoshatarë të tij. Dhe sipas traditës hinduiste u martua shumë i ri me Kasturbai Makhanji-n, sipas dëshirës dhe vendimit të prindërve të tij. Sipas këtij kuptimi fetar dhe kulturor burri është zotëri absolut i grave dhe fëmijëve, gjersa gruaja është skllave, e cila duhet në gjithçka ta dëgjojë burrin dhe atij t'i nënshtrohet në gjithçka. Kështu u sillën edhe prindërit e tij. Mirëpo, gruaja e tij Kasturbai, edhe pse nga shtresa dhe besimi, nga kultura dhe tradita e njëjtë, shpeshherë nuk sillej ashtu. Bile refuzoi edhe betimin e besnikërisë dhe të dashurisë së përjetshme martesore!

Bashkëshortja – mësuesja e parë

Mohandas K. Gandhi, nga ky gjest i gruas së tij ishte aq i turpëruar, saqë “humbi kokën” kështu që i ndaloi gruas çfarëdo kontakti me botën jashtë mureve të shtëpisë. Pas shumë viteve të rënda dhe të tensionuara martesore, pas lutjeve, meditimit dhe agjërimeve, arriti deri te ky përfundim i guximshëm: *„Gruaja ime Kasturbai më mësoi jodhunën, atëherë kur kam dashur t'i /imponoj vullnetin tim. Në njërën anë rezistenca e saj e durueshme, në tjetrën anë bartja në heshtje e vuajtjeve të cilat ia shkaktova unë me marrëzirat e*

mia, më ndihmuan që të kuptoj marrëzinë time, më bënë të turpërohem dhe pikërisht vetëm kështu e kam ndërruar mendimin se kam të drejtën natyrore ta sundoja atë.“

Mohandas ngadalë, por me një siguri, gdhendte natyrën e tij të egër rinore, bëhej gjithnjë më i butë, më human, më pak agresiv, i durueshëm dhe matur.

Ende shumë i ri është dashur ta braktiste familjen, të largohej nga India, për të studiuar në Londër. Ky udhëtim dhe qëndrim i tij në Londër ishte i rrezikshëm nga shumë pikëpamje, shkaku i mentalitetit perëndimor: për shtresën (kastën), për religjionin hindu, për kulturën, traditën, martesën. Para udhëtimit është dashur të betohet së paku në këto tri gjëra: se nuk do pinte verë, të mos ngrënte mish e të mos kalonte me gra të huaja!

Një nga udhëheqësit e sektit fetar nuk dëshironte t'ia lejonte kurrësi këtë udhëtim, për arsye se këtë ia ndalonte hinduizmi. Mohandas me nervozizëm tha: *„Feja e cila do të ishte e kufizuar në hapësira të caktuara, më nuk do ishte fe. Feja është në zemrat e njerëzve, e jo brenda kufijve shtetëror.“*

Duke refuzuar urdhrat e dëgjueshmërisë së kastës, ai u bë i “mallkuar”, që i dëbuar dhe i konsideruar si i përjashtuar nga feja dhe kasta. Me këtë e këso përcjelljeje dhe disponim Mohandas niset në udhëtimin e tij nëpër botë.

Qëndrimi në Londër

Mohandas K. Gandhi ishte 19 vjeçar, kur arriti në Londër. Kërkoj mënyra se si t'i pajtonte dy bota tërësisht të ndryshme, shpesh edhe në kundërshtim, Hinduizmin dhe Perëndimin. Shpeshherë e kujtoi betimin, rebelimin e brendshëm kundër traditave të hinduizmit, shtresave të parisë, të gruas, të birin. Dëshironte të jetë dhe mbetet vetvetja, por në të njëjtën kohë të jetë edhe sikur të tjerët, evropian. Mori mësimë në vallëzim, veshi frakun tipik, shkurtoi flokët në mënyrën e stilit evropian, mësoi t'i binte violinës, vizitoi teatrin. Mirëpo gjithçka ishte gati e kotë, meqë nuk arriti të jetë anglez, sepse ishte shumë i ndryshëm nga ata. Atëherë i kthehet vetvetes: mësoi dhe lexoi shumë, në veçanti disa tekste të shenjta, Biblën, Kuranin, Veden, disa filozofë grekë. Ishte jashtëzakonisht i mahnitur me Dhiatën e Re, figurën e Jezu Krishtit. Ja dëshmia e tij: *“Mbeta i mahnitur me Besëlidhjen e Re, në veçanti me Predikimin në Mal.“* Brenda tre viteve (1888 – 1891), përfundoi fakultetin e drejtësisë dhe

qe pranuar në Shoqërinë e Avokatëve të Londrës. Në këtë periudhë i vdesin prindërit. U kthye në Indi me 12 maj 1981, me dëshira dhe plane të reja dhe të shumta. Mirëpo, realiteti i Indisë është gjithmonë i njëjtë, tejet i rëndë, të ndarë në kaste, në religjione, me skamje, varfëri të skajshme, me shumë padrejtësi shoqërore.

Detyra e parë e tij profesionale si avokat ishte problemi i bashkëkombësve të tij në Afrikën Jugore, ku jetonin e punonin diku rreth 70.000, në kushte të degradimit dhe shfrytëzimit çnjerëzor. I quanin “mall” (“kuliji”) dhe ishin të përjashtuar nga çdo e drejtë njerëzore.

Avokati antiracizmit në Afrikën Jugore

Qysh gjatë udhëtimit të tij për në Afrikën Jugore ai përjetoi në lëkurën e tij diskriminimin racor. Udhëtoi me tren dhe kishte rezervuar biletën në klasën e parë. Kur erdhi kontrollori i biletave, e detyroi të largohej nga treni, sepse ky ishte qytetar i Indisë, dhe si i tillë nuk kishte të drejtë të udhëtonte në klasën e parë, por vetëm me atë të tretën! Kështu, Mohandas mbeti në stacionin hekurudhor tërë natën, duke menduar mbi padrejtësitë e zotërinjve të bardhë ndaj tjerëve.

Çka të bëhet, si të mbroheshin të drejtat themelore njerëzore të zezakëve në tokën dhe shtetin racist? Pas takimit dhe përjetimit personal të diskriminimit vendosi guximshëm: *„Do qëndroj me këta këtu për të luftuar. Vepra ime do jetë e përsosur vetëm nëse arrij të bindë tërë botën se secili njeri, burrë apo grua, edhe pse fizikisht e dobët, është mbrojtëse e lirisë personale!”*

Për këtë vendosi të realizonte shumë takime, biseda me bashkëkombësit e vet. I mësoi të jenë të durueshëm, të duanë, të besojnë në Zotin, në vlera morale. Të gjithëve shpesh iu fliste kështu: *„Kini kujdes, urrejtja lind vetëm urrejtje. Për këtë ne askurrë nuk dëshirojmë rrënimin e armiqve tanë, por të mirën...Ne jemi kundër ligjeve të padrejta, por kurrë kundër njeriut!”*

Mohandas K. Gandhi hap pas hapi arrin deri te dukuria e parë e madhe e quajtur satyagraha – fjalë indiane e cila shënon kërkimin e së vërtetës dhe dashurisë, kurse në kuptimin e gjerë do të thotë jodhunë dhe padëgjesa qytetare kundrejt pushteteve të cilat shkelin të mirën e përgjithshme.

Njerëzit e dëgjojnë dhe ngadalë pranojnë këto porosi të reja e të panjohura duke dëshiruar ta ndjekin „Mësuesin“, siç e quanin të gjithë, në kërkimin e ri të rrugës së drejtësisë, kështu që të arrihet deri te e drejta dhe dinjiteti i njeriut.

Burrat, pra, fermerët e bardhë me prejardhje holandeze, ishin të pranishëm në Afrikën Jugore që nga viti 1600, dhe çdo gjë ishte në duar të tyre, sepse ishin të pasur dhe të fortë, shfrytëzonin fuqinë dhe punën e zezakëve. Ata kishin shumë konflikte me Anglezët.

Mohandas Gandhi, mblodhi bashkëkombësit e vet në shoqëri, të cilën e quajti Indian Ambulance Corps, për luftë dhe mbrojtje të drejtave themelore njerëzore dhe qytetare. Nisej gjithmonë nga jeta dhe përvoja e tij personale: diktatura e babait të tij ndaj së ëmës, shtresat parie (kastet), rasti i Ukas dhe djalit të tij, konflikti që kishte me gruan e vet Kasturbai dhe pa dëgjesa qytetare, përvoja nga Londra dhe takimi-ndeshja me Perëndimin, njohja e Ungjillit, Jezu Krishtit, diskriminimet e ndryshme racore në tren...


Vitin 1907 ndodhi diskriminimi klasik i të bardhëve ndaj zezakëve: në Transvaal, është kërkuar që zezakët të paraqiten në zyrat policore që të lënë gjurmët e gishtërinjve. Në këtë mënyrë që të gjithë ishin të regjistruar si kriminel potencial. Indianët refuzuan këtë ligj racist në mënyrë paqësore. Gandhit iu bashkuan edhe shumë të tjerë në këtë luftë të drejtë. Gjenerali pas bisedimeve të shumta, pranoi që së paku në letër të pranonte barazinë edhe të Indianëve në Afrikën Jugore.

Mirëpo, për Gandhin kjo nuk mjaftonte. Ai, e vazhdoi „luftën“ edhe më tutje dhe propozoi bashkëkombësve të tij këtë: *„Sa njerëz tanë, në veçanti në Atdhe, janë robër të ligjeve kastore?...E, megjithatë, ne të gjithë jemi bijtë e së njëjtës Nënë Indi!”*

Në vitin 1912 edhe një herë ligji racist „goditi“ shumë mërgimtarë nga India dhe shumë zezakë tjerë nga pjesët e ndryshme të Afrikës: shpallën jashtëligjore të gjitha martesat të cilat nuk janë të lidhura sipas riteve të krishtera! Me këtë qenë shkatërruar shumë familje, dinjiteti i gruas, martesës, ligjshmëria e fëmijët. Gandhi edhe njëherë ftoi në mosbindje qytetare duke organizuar një demonstratë të madhe, në veçanti të minatorëve në Newcastle, ku një pjesë e madhe ishin zezakë. Ai iu tha: *„Dëshiroj t'i prek zemrat e të bardhëve të cilët na sundojnë ne dhe shfrytëzojnë punën tonë... Edhe ne jemi njerëz si ata!”*

Marshi i madh i paqes

Ligji i dytë racist ishte ky: punëtorët e ardhur nga India, të cilët do të dëshironin të shpërnguleshin nga një krahinë e Afrikës Jugore në tjetrën, është dashur të kanë pasaportë të brendshme ose një lloj



leje të veçantë. Gandhi tani më ishte lider i bashkëkombësve të tij dhe vitin 1913 organizon karvanin e madh të paqes drejtuar kah kufiri. Shumica e tyre dëgjin pasaportë, fletudhëtimet dhe pa farë dokumentesh qetësisht kalojnë kufirin. Gjithë janë të bashkuar, lutën, këndojnë, vallëzojnë dhe protestojnë në mënyrë dinjitoze. Këtë herë pushteti ndaloi Gandhin dhe shumë të tjerë. Mirëpo, e gjitha ishte e kotë, sepse tanimë populli ishte i vetëdijësuar, i bindur se ndaj padrejtësive duhet luftuar përmes rrugës paqësore. Shtypi jugo-afrikan, si dhe ai botëror, flisnin dhe shkruanin mbi të voglin-madhin Mohandas Gandhi-n i cili udhëhiqte një revolucion të qetë, ende të panjohur në botë. Shumë e quajtën Profet të jo-dhunës, të paqes, faljes dhe dashurisë së përgjithshme.

Avokati i të shtypurve thotë: „Ekziston një e

drejtë të cilën nuk mund të na marrë asnjë i bardhë. Dëshirojnë të na poshtërojnë e të na bëjnë njerëz të racës së ulët, duke vepruar me ne nëpërmes forcës dhe dhunës. Ne do të luftojmë në mënyrën tonë për heqjen e ligjeve të padrejta...

Fitorja do jetë e jona, do jetë e gjithë njerëzimit.“

Kryetari I Afrikës Jugore Smutsi kishte kërkuar në çdo mënyrë ta kundërshtonte veprimtarinë tij, por ishte e kotë; ishte detyruar që të dorëzohej dhe të lëshonte pe para një “gjeneralit” të pazakontë – Gandhi-t dhe t’i heq braktiste disa ligje raciste qysh vitin 1914. Pra, Gandhi, apo më mirë të themi, drejtësia ngadhënjeu!

Benjamín GONZÁLEZ BUELTA S. I.
Itali

PUSHTIMI I BOTËS DHE PUSHTIMI I ZOTIT

Kultura e pushtimit

Sociologët na thonë që ne po jetojmë në një kulturë pushtimesh. Pas rrëzimit të utopive të mëdha të epokës moderne, kapitalizmit dhe socializmit, një ndjenjë e zhgënjimit e ka mbushur hapësirën e shoqërisë post moderne. Shumë mendime dhe iluzione të kaluara duken të humbura : nuk i kanë plotësuar pritshmëritë tona. Përballë boshllëkut të inferioritetit dhe humbjes së dimensionit të botës, që na bën të ndihemi jetim, janë zhvilluar dy projekte të mëdha, të afta për të magjepsur edhe një herë botën : *konsumimi* dhe *argëtimi*.

Konsumimi është një zbulim i mrekullueshëm që shkon në çdo vend të botës, ku gjendet ndokush që ka pak lekë në xhepa. Si simbol marrim qendrat e mëdha tregtare, ku jo vetëm që mund të konsumosh gjithçka, por edhe formohet një mënyrë e të ushqyerit, e të veshurit, e të udhëtuarit dhe e të argëtuarit. Është e gjitha një stil jetese ajo që blihet. Në qendrat e mëdha produktet janë ofruar me bollëk, ato janë të ekspozuara me lojën e ngjyrave, të dritave dhe të pasqyrave. Frymohet aroma e sofistikuar që vjen e padukshme mes impianteve të klimës, me një muzikë që na fton të qetësohemi dhe të përfundojmë gjithçka, pa u menduar të shikojmë orën. Duket Toka e premtuar dhe ato hapësira dëshirojnë të na lirojnë nga nevojat tona.

Projekti i dytë i madh është argëtimi, kalimi i kohës, heqja e vëmendjes. Njëzet e katër orë në ditë dhe në të gjitha ambientet na ofrohen diapozitiv elektrik që mund të na lidhin menjëherë me një film, muzikë, eveniment sportiv dhe çdolloj spektatori. Kanë lindur zotat e ri të kulturës aktuale. Nuk është më koha e heronjve, as e martirëve,

por ka ardhur ora e personazheve të famshme, që zënë një hapësirë të mrekullueshme në komunikim, me meritat e tyre, apo me sjelljet e tyre të veçanta.

Për të shitur prodhimet e konsumit dhe të argëtimit, në sallat e prodhimit të televizorit dhe të revistave, në studiot e regjistrimeve dhe në laborator zhvillohen vazhdimisht ndjenja të reja, të forta, inteligjente, që hyjnë tek ne përmes emocioneve dhe depërtojnë në brazdat gjithnjë të hapura të oreksit tonë natyral ose artificial të provokuar nga dyqani. Çdo ndjesi është studiuar me përpikmëri. Parfumi i një hoteli, zhurma e një fshese me korrent, kërcitja e një ushqimi të thatë kur përtypet, apo e një rrobe që griset, zhurma e sportelit të një veture luksi kur mbyllet, janë elemente të studiuara mirë nga specialistët deri kur arrijnë në pikën e marrjes së ndjesisë perfekte. Asnjë gjë nuk i është lënë rastësisë. Çdo ndjenjë është e studiuar me shumë imtësi, për t'u pushtuar nga efekte speciale, që duken sikur kanë dalë nga trasta e një magjistari. Na gënjejnë dhe na verbojnë.

Neuromarketingu studion, me mjetet më të



sofistikuara të teknologjisë aktuale, në cilën mënyrë reagimet shkojnë në trurin njerëzor, për të kërkuar ato që shkojnë direkt deri në fundin emocional të subkoshencës, ku zhvillohen përgjigjet dhe vendimet tona. Publiciteti i flet para së gjithash trupit dhe sferës emotive, duke tejkaluar logjikën, pasi duhet të krijojmë përgjigje të programuara. Ajo merr vendimet për ne. Na mjafton të bëjmë një “klik” në tastierë: duhet vetëm ta lëmë veten të transportohemi dhe të rrëshqasim në emocionin e ndjenjës. *“Jetojmë në një botë të takimeve dhe të ndeshjeve të shpeshta, por të emocioneve të pakta”* (A. Guidens).

Në këtë kulturë pushtimi vlen vetëm ajo çfarë perceptojnë ndjenjat, prandaj kultivohen pamjet e jashtme, i mbivendoset dukja ekzistencës dhe e realitetit. Ndërsa trupi dhe situatat emotive të subkoshencës janë manipuluar nga pushtimi; mendimi është i dobët dhe vendimet janë të pasigurta. Thuhet “*po*” pa thënë “*jo*” dhe detyrimet e çiftit, të miqësisë, të grupit, të punës kanë jetëgjatësi të shkurtër.

Sfida e këtyre kohëve është prezantuar qartësisht nga psikoterapisti jezuit Carlos Dominguez Morano: *“Nuk është e rëndësishme të insistojmë në rëndësinë që e gjithë psikologjia bashkëkohore ka vendosur t’i japë konceptit të pushtimit: është një vlerë që disa nuk hezitojnë ta kualifikojnë si mitike në çdo rast, është e provuar sigurisht që pushtimi ynë është i varur nga stimulimet e jashtme, më shumë sesa narcisti ynë do të donte të kalonte. Tonaliteti ynë i brendshëm ndryshon çdo herë në funksionim të kampeve të stimulimit në të cilin jemi përfshirë.”*

Nëse ndjenjat tona i marrim në aspektin fetar, mund të perceptojmë dimensionet më të thella të realitetit. Gjëja më e keqe që mund të bëjmë do të ishte të refuzojmë këtë kohë dhe të pretendojmë të mbyllemi në një kullë të paarritshme, në një fluskë të pamundur dhe të shëtisim rrugëve me një maskë, t’i afrohem njerëzve me një gjest të refuzimit dhe të dënimit, duke profetizuar kundër kësaj kulturës sonë.

Ka mbaruar dashuria e Zotit për këtë botë? A ka mbaruar imagjinata e tij për të krijuar oferta për jetë të reja? A janë krijuesit e ndjenjave pushtuese që kanë ekskluzivitetin për të pikturuar botën e së nesërme? Por, Shpirti i Zotit vepron edhe në këtë kulturë. Nuk ekziston popull, as kulturë, as besim, as situatë njerëzore, asnjë person në të cilin Zoti nuk është i pranishëm për të krijuar njerëzimin e ri. Ku sociologët dhe antropologët ndalen me përshkrimet

e tyre, gjejmë propozimin e Shpirtit. Edhe në терминаlet elektrike që i kemi në shtëpitë tona, edhe në rrugët ku kalojnë njerëzit me veshje të markave, duket Shpirti Shenjtë. Por, duhet të kesh ndjeshmërinë për ta perceptuar.

Sfida jonë nuk është t’ia mbathim realitetit, por t’i afrohem asaj me të gjitha shqisat e hapura mirë për të shikuar dhe parashikuar, për të zbehur mbeturinat e aparençave pushtuese dhe të shikosh, të dëgjosh dhe të shijosh realitetin, duke perceptuar në thellësi të saj prezencën e Zotit që na do me një krijimtari të jashtëzakonshme, pasi do të takohemi me të dhe të punojmë së bashku për mbretërinë e Tij. Shoqëria jonë nuk ka nevojë vetëm për profetë, të cilët denoncojnë të këqijat që na ndodhin, por të mistikëve që zbulojnë se ku po krijon Zoti diçka të re, për të proklamuar këtë lajm të mirë. Nuk është e nevojshme vetëm që të afirmojmë që Zoti e do këtë botë, por edhe të theksojmë se ku ai vepron, duke mbledhur dramën jetësore moment pas momenti. Shoqëria ka nevojë për persona që me një ndjeshmëri hyjnore të mund të takojnë Zotin nga padrejtësia dhe çdolloj tipi të përjashtimit.

Ndjesia e re drejt misterit

Mbretëria e Zotit zhvillohet në mesin tonë, në hapësirat në të cilat tentojmë t’i shikojmë gjërat vetëm përmes shikimit të atyre që çdo ditë na mësojnë realitetin e perspektivës dhe të interesave të veta. Imazhet e realitetit mbajnë në vete një shpirt të fitimit, të militantës politike, të tërheqjes për një spektakël. Nuk janë të padjallëzuara.

Kur Jezusi vëzhgonte realitetin e kohës së tij, thoshte atë çfarë shikonte, e jo vetëm atë çfarë sinagoga e mësonin që të shikonte *“Mbretëria e Zotit është në mesin tuaj”*. (Lc 17, 21). Isaia në Babiloni i thoshte hebrenjve që prej kohësh ishin të mbyllur në një azil pa rrugëdalje: *“Ja, shikoni: unë po bëj një gjë të re: e pikërisht tani nuk po e vëni re?”* (Is 43, 19). Të shikosh është një referim ndaj ndjesive, ndjeshmërisë. Përballë një vepre të një artisti gjenial, ne mund të kalojmë përtej, pasi nuk kemi mundësinë të perceptojmë artin që ajo shpreh, por kush ka një ndjeshmëri të rafinuar mund të perceptojë të bukurën dhe të hyjë në universin human që kjo vepër sugjeron.

Nuk ka të bëjë thjesht me të diturit se mbretëria e Zotit manifestohet në mënyrë konkrete, ndonjëherë në një mënyrë shumë të thjeshtë, me dialogë, fytyra, këngë, punë, etj.

Shën Injaci tek *“Ushtrimet”* thotë që personi që lëviz sipas verbërisë së tij është i dënuar, përmes

vëzhgimit të Jezusit, që të shohë vizionin e veprës së Mbretërisë dhe risisë që Zoti sot vepron në mesin tonë.

Respekti i realitetit

Shpesh mendohet që eksperiencia fetare na largon nga realiteti dhe na bën që të humbim në mendime të largëta. *“Tjetri, shokët, ceremonitë fetare, bukuria e botës, nuk bëhen joreale pas kontaktit direkt të shpirtit me Zotin, madje është pikërisht atëherë që bëhen të vërteta gjërat që më përpara ishin thjeshtë ëndrra”* Simone Weil”.

Në dy mënyra ne fshehim realitetin dhe nuk e respektojmë kur e idealizojmë apo e djallëzojmë. Ndonjëherë idealizojmë realitetin, pasi nuk mund të durojmë ta shohim aq të ngurtë, apo pasi e duam aq shumë sa që nuk dëshirojmë t’ia shohim defektet. Ndonjëherë e djallëzojmë, pasi nuk na leverdis të shikojmë diçka të mirë tek një person, apo situatë. Por, me të njëjtat ngjyra të ndritura që përdorim kur e idealizojmë, apo me ngjyra të errëta që përdorim kur e djallëzojmë, ne përgënjeshtrojmë realitetin dhe po në atë kohë fshehim dhe veprat e Zotit në thellësi të këtyre situatave.

Janë disa aspekte të realitetit që vetëm përmes instrumenteve shkencor mund të realizohen, për shembull vetëm përmes një mikroskopi mund të zbulohen mikrobet në ujë. Një shikim shkencor mund të përshkruajë të gjithë anët e një personi që vjen dhe zhduket në mendjen e tij të sëmurë, por shikimi soditës mund të dëgjojë dhe shijojë dinjitetin e pafundmë të një njeriu të Zotit. Ky zbulim mund të rizgjojë dinamizma mahnitëse vepruese.

Mistiku, me sy të hapur mund të jetë më realisti, pasi shikon jo vetëm sipërfaqen, por të vërtetën e fundit ku Zoti vepron, pa pushuar, me një përkushtim të pafundmë dhe hap mundësi të reja.

Shenja të reja për të dëgjuar dhe shijuar veprimet e Zotit në botë.

Ku realiteti është bërë transparent për ne, aty lind një sakrament i takimit me Zotin. Në situatat e dhimbjes e takojmë Zotin pikërisht aty ku fshihet, por kur manifestohet na ndalon që të shtrijmë dorën pushtuese për t’u përqaftuar me të mirën apo të keqen.

Takojmë sakramente universale që të gjithë bota i kupton. Në varrimin e Nënë Terezës, ishin të mbledhur në lutje ato që në jetën reale ishin kundërshtarë: myslimanë, hindu dhe kristianë. Të tjerët janë “shenja kontradiktore”, siç vetë Jezusi

dhe të tjerët që ecin në hapat e tij, të cilët do të na njohin vetëm në të ardhmen.

Në jetën tonë njerëzore eksperimentojmë sakramente në udhëkryqe, që e ndan jetën në një të parë dhe një të dytë, siç ishte dhe eksperiencia e Injaci në Manresa. Kemi edhe sakramente të vogla të jetës sonë të përditshme, që kalojnë pa u perceptuar, por që ngrohin me një dritë të ëmbël përditshmërinë tonë. Klasat shkollore, kuzhina e shtëpisë, rrugë në të cilën jetojmë dhe zyrat mund të bëhen kioska, hapësira që flasin për Zotin, ndonjëherë pa e vënë re.

Al p. Kolvenbah, dekan i përgjithshëm i shoqërisë së Jezusit, u pyet nëse, kur lutej, i shikonte apo jo ikonat orientale? Ai u përgjigj: *“Jo, janë ato që më shohin mua”*. Kur hapësira që na rrethon do të bëhet transparente, do të ndiejmë që Zoti na shikon dhe do të jetojmë duke ndjerë një prezencë që na ngjyros jetën e ndjenjave.

Një ndjesi e re soditëse.

Përmes procesit që kemi përshkruar, tani të shikojmë sesi mund të transformohen ndjenjat tona. Përballë një peizazhi, një piktor do të shohë të gjitha ngjyrat, inxhinieri do të shohë një rrugë që mund të bëhet urbane, një ekologjist do të shohë speciet që duhet t’i shpëtojmë. Përballë një peizazhi me borë, ne do të themi që është i bardhë, por eskimezët që jetojnë gjithnjë në borë dhe në ngricë, kanë me dhjetëra emra që mund ta quajnë borën. Një soditës do të vërejë të gjitha dimensionet e realitetit, madje dhe ato të fshehura, pikërisht aty ku Zoti punon vazhdimisht, në mënyrë që jeta që na solli Jezusi të mund të jetohej në plotësi.

Kjo mënyrë e perceptimit të realitetit mund të zgjojë tek ne dinamizme të jashtëzakonshme të të jetuarit, në vend që të bëhemi pesimistë dhe të trishtuar nga zhgënjimi. Shën Injaci, tek Ushtrimet, na propozon që të jemi soditës ashtu siç Jezusi kur u afronte tek realiteti me pesë shqisat. Jezusi ka zbuluar, në realitetin e kohës së tij, që bota e Zotit ishte në mes të popullit. Ky proces që kemi përshkruar na lejon që të lindim edhe një herë për të shikuar mbretërinë e Zotit (cfr Gv 3, 3).

“Nuk ka asgjë profane për kë di të shikojë” (Teilhard de Chardin).

Përkthyer nga revista kulturore – fetare “La Civiltà Cattolica”, 11-25 mars 2017.

Përktheu: Bernardina Shahini

Gëzim LOKA

**DOM NIKOLLË KAÇORRI, NJË IKONË
NË GJYSMËHIJE E PAVARËSISË KOMBËTARE
(1862-1917)**



Më emrin e Dom Nikollë Kaçorrit, meshtarit të Pavarësisë, zv/kryministrit të qeverisë së Vlorës, lidhte një nga epokat më të ndritura dhe më të vështira njëherësh të historisë sonë kombëtare. Më gjithë kontributin e madh në shpalljen e Pavarësisë dhe funksionimin e të parës qeveri shqiptare, emri i tij është lënë në gjysëmharresë dhe nuk i është dhënë merita që i takon. Në Diktaturë emri i tij përmendej, por me një lloj ndrojtje, ndërsa në këto vite të hapjes së Shqipërisë, figura e tij e plotë nuk ka dalë në pah, siç i takon në panteonin e lavdisë kombëtare.

Dom Nikollë Kaçorri u lind në fshatin Krejë, Lurë në vitin 1862, fshat ky që ndan dy krahina të mëdha: atë të Dibrës e Mirditës, me një histori të denjë si gjithë Lura, Dibra e shqiptaria. Ai rridhte nga një familje, me babain katolik, ndërsa nëna me besim mysliman, duke promovuar atë që jo vetëm në Lurë por ë të gjithë Shqipërinë është modeli i bashkëjetesës fetare. Falë zgjuarsisë dhe dëshirës për t'u shkolluar, djalioshi ra në sy t'arkipeshkvit të Durrësit n'atë kohë, imzot Ambrosio, i cili gjatë një vizite në Lurë, duke parë shkathtësinë, inteligjencën dhe zgjuarsinë natyrale të tij, u kujdes që ta shkollonte dhe ta bënte meshtar.

Më 1884 mbaroi studimet filozofiko – teologjike për meshtar dhe u shugurua në Shkodër. Me kalimin e kohës kompletohet me shkollë të rregullt, kulturë të lartë, duke mbaruar në vitin 1890 në Zvicër për teologji, politikë, filozofi e

magjistraturë me nota të shkëlqyera. Gjithë shpenzimet për shkollimin e tij i kreu e kasha e priftërinjve. Ai ishte sekretar i Arqipeshkëvisë së Durrësit me qendër asokohe në Delmnisht të Kurbinit, ku shërbeu për njëzet vjet, duke patur në administrim edhe kishat dhe famullitë e Kthellës, Selitës dhe Lurës. Pastaj u emërua famullitar në Durrës. Për veprimtarinë frytshme kishtare, Papa i asaj kohe e nderoi me “Kryqin e artë”, “Për Kishë dhe Papë”. Pas këtij dekorimi, niset me shpejtësi për të kryer me përkushtim detyrën e lartë. Shpejt avancon, ishte ndër të parët në organizimin e shoqërive patriotike "Vllaznia", "Bashkimi" Durrës (1907 - 1909), mjedise këto ku takoheshin

intelektualët më me zë duke veçuar bashkëpunimin e ngushtë me Abdi Toptanin dhe Mustafa Merlikën, duke patur si problem primar dhe imediat – rilindjen e Shqipërisë, arsimimin dhe gjuha shqipe. Gjatë 1905 – 1907 drejtoi kryengritjen e armatosur kundër turqve në Kurbin. Pajis popullin me 500 armë, armë që u shpërndanë në Kthellë të Mirditës. Në bashkërendim me Gjin Pjetrin e Skurajve, i paraprin shpalljes së pavarësisë, duke udhëhequr me pushkë e penë kryengritjen mbarëkombëtare nga veriu në jug, në gjithë Shqipërinë etnike. Më 1908, Kaçorri mori pjesë në Kongresin e Manastirit.

Në vitin 1909 mori pjesë në Kongresin Kombëtar të Elbasanit, Edhe pse i ndjekur e i përndjekur, Imzot Kaçorri nuk i shkëputi asnjëherë lidhjet me çetat kryengritëse, sidomos ato që vepronin në zonën e Kurbinit dhe në Malësitë e Kthellës, ku përfshihej edhe vendlindja e tij, Lura. Në momentin kur ishte përfshirë për një kryengritje të armatosur në gjithë Shqipërinë. Për gjyqin dhe dënimin me disa vjet burg dhe gjobë në të holla boton gazeta “Dielli”.

Përndjekjet, gjyqet, kërcënimet kundër tij nuk pushuan një çast, aq sa gjendjen e tij e përcollën jo vetëm gazetatat shqiptare të mërgimit, si gazeta “Dielli”, por edhe gazetatat e huaja si “Corriere di Trieste” apo edhe shtypi austriak me të cilin ishte i lidhur posaçërisht, edhe për shkak të njohjes së

gjuhës, pse atje kishte krye studimit. Ai me një zgjuarsiri të rrallë, në polemika me klerikë myslimanë dhe ortodoksë, – të cilët predikonin, të parët gjuhën arabisht dhe turqisht, të dytët greqisht, – porosiste: "Të predikojmë në gjuhën shqipe, se Zoti na ndigjon edhe shqip!". Në Durrës gjendja e tij bëhej gjithmonë e më e vështirë: Ishte një paradoks, po ai u gjend në mes dy zjarreve, pushtetarëve otoman, që e kishin përherë nën mbikëqyrje, e në bashkëpunim me ta edhe nga dhespoti i Kishës Ortodokse, Jakovi. Popullsia myslimanë e Durrësit dhe e Shijakut, edhe pse e ndërsyer kundër tij nga turqit, nuk e tradhtoi kurrë, po përkundrazi, e mbështeti, e mbrojti, shpesh herë edhe me armë.

Ishte Imzot Kaçorri ai që priti delegacionin e mërgatës, që arriti nga Trieste me datë 22 Nëntor 1912. Durrësi ishte parashikuar nga atdhetarët si qyteti ku do të bëhej Shpallja e Pavarësisë. Por trazirat dhe trupat serbe n'afrim nuk lejonin qetësi. Bashkëkohësit e përshkruajnë si një klerik jo fort paqësor: Ishte kohë kryengritjesh për liri dhe meshtari nuk i shmangej as luftës së armatosur. Në nëntor të vitit 1912, si delegat i Durrësit, mori pjesë në kuvendin e Vlorës dhe firmosi dokumentin e Pavarësisë me siglën "Kaçorri". Në mbledhjen e 41 delegatëve që kishin mbërritur në Vlorë, atdhetari Nikollë Kaçorri ngrihet e thotë:

"Në qoftë për nesër, vdesim sot, o flamur o dekl!" Kjo ishte një postulat i lirisë dhe dinjitetit shoqëror të shqiptarisë. Këto thirrje u bënë himn për të gjithë pjesëmarrësit. Në këtë moment mund të themi se del si figurë më lart se bashkëpunëtorët e tij dhe ka plotësisht të drejtë historiani dhe studiuesi i mirëfilltë, lursi Sali Ajazi që e ka përcaktuar si "politikan të nxehtë", por rezultativ në momente sfide dhe kritike. "Sot, – përgjigjet me lot në sy plaku i nderuar Ismail Bej Vlora, – në mes të një gëzimi të papërshtatshëm shpallet pavarësia e Shqipërisë". Dom Nikollë Kaçorri ishte në krah të plakut legjendar jo vetëm me penë e drituri, por dhe me armë në dorë. Ai u zgjodh nënkryetar i qeverisë shqiptare. Kuvendi i Vlonës, i çelun në orën 14⁰⁰ të datës 28 Nëntor 1912, miratoi Shpalljen e Pavarësisë. Firmë e dytë, mbas Ismail Qemalit, ishte Imzot Nikollë Kaçorri.

Ismail Qemali vinte pas një kohë te gjatë mërgimi dhe vinte në një terren të përgatitur sigurisht nga pjesa e atdhetarëve të shquar të cilët për një ngjarje të tillë të madhe kishin bërë një punë kolosale, dhe në krye të këtyre punëve ishte Dom Nikollë Kaçorri, ku në këtë rast mund të themi pa mëdyshje se ky post i rëndësishëm iu dha edhe si një lloj shpërblimi për punën që kishte bërë në

përgatitjen e situatës së brendshme përfshirë këtu edhe atë të sigurisë, për shpalljen e Pavarësisë Kombëtare. Pas rënies së kësaj qeverie, u tërhoq në Durrës. Me shpërthimin e kryengritjes së Shqipërisë së mesme me kryetar Haxhi Qamilin, i cili do t'i digjte qelën ku banonte dhe t'i shkatërronte bibliotekën e tij personale, ndër ma të pasunat në Shqipëri në atë kohë. Emigroi jashtë atdheut, ku vazhdoi veprimtarinë e vet politike e patriotike. Pas dështimit të Qeverisë së Ismail Qemalit imzot Nikollë Kaçorri së bashku me Mustafa Krujën, Luigj Gurakuqin, Themistokli Gërmenjin themeloi lidhjen "Për atdheun e për Thronin" për shpëtimin e atdheut nga trazirat e ndryshme antikombëtare. Me dekret të 28 janarit 1916, Franc Jozefi - perandori i Austro-Hungarisë dekoroi me Kryqin e Konturës (Kommtur Kreuz) të Urdhërit të Franc Jozefit. Pas gjithë kësaj së bashku me shumë atdhetarë të tjerë imzot Nikollë Kaçorri emigroi në Austri, ku qëndroi tri vjet në Vjenë derisa vdiq me 29 maj 1917, nga një sëmundje e pashërueshme. Ai ishte i sëmurë nga mushkëritë dhe erdhi në Vjenë për ekzaminim e mjekim, por sëmundja kishte përparuar aq shumë sa edhe mjekësia e përparuar austriake nuk kishte çfarë të bënte më tepër. Vdiq në sanatoriumin Würth, pasi vuajti tre-katër muaj, më 29 maj 1917. Varrimi i tij u bë më 1 qershor 1917 në Zentralfriedhof. Në varrim morën pjesë komandanti i krahinës së Tiranës, Feldmarschall Braun, kryekonsulli i Shkodrës, Rappaport, Kviatorsski, Vinter si dhe e veja e konsullit austro-hungarez në Durrës, baronesha Lovontal-Linau, si dhe shumë diplomatë të tjerë. Më 2 qershor u mbajt një meshë nderimi për të në kishën Maria Treu në Vjenë. Varri i Dom Nikollë Kaçorrit gjendet në "Central Cemetery" në grupin 84, rreshtin 32, numër 19. Varri në këtë vendndodhje nuk ka asnjë shenjë guri, apo pllake, për shkak se në të gjendet aktualisht një pemë shumëvjeçare. Fakti që ai mbajti petkun e meshtarit, mbase u bë shkak që gjatë gjithë regjimit komunist portreti i tij patriotik dhe roli i tij në formimin e shtetit shqiptar u kalua mjaft tangent, duke u eklipsuar nga figura të tjera.

Të qenit e tij në gjysëmshije erdhi për shkak jo vetëm të rrobës së tij klerikale, por dhe për atë rol parësor që ai kishte në aktin e Pavarësisë, por për shkak të konjunkturave të kohës, të vjetra e të reja, ky rol nuk është nxjerrë në pah aq sa duhet, pasi emir i tij nuk meriton të jetë vetëm në një shkollë të thjeshtë fshati në Lurë, por në rrugë e sheshe në Tiranë, Vlorë e kudo në shqiptari, ku pritet me dashuri e fisnikëri emir dhe vepra e paharruar e Dom Nikollë Kaçorrit.

Prof dr. Edmond MALAJ
Tiranë

NJË HISTORI E RËNDËSISHME PËR KULTURËN SHQIPTARE

*(Recension mbi veprën “Kisha Katolike në Trevat Shqiptare”
të autorit Dr. Dom Nikë Ukgjini. Botues, Shoqata e Jezuitëve, Tiranë 2016)
Organizuar nga Shoqata “Don Gjon Buzuku” Ulqin, 4 mars, 2017.*

Dr. Dom Nikë Ukgjini është pedagog i lëndës së Historisë së Kishës pranë Seminarit Ndërdioqezan dhe është marrë për një periudhë të gjatë kohe me këtë subjekt, është njohës i mirë tij dhe kjo vihet re edhe në punimin që po paraqesim sot. Dom Nika me këtë monografi po i jep lexuesit shqiptar një vepër shumë të kërkuar në lidhje me historinë e pahulumtuar përfundimisht të Kishës Katolike në Trevat Shqiptare. Autori e ka ndarë punimin e tij në katër kapituj, në të cilat jepet historia e Kishës përgjatë nëntë shekujve, nga shekulli XI deri në ditët e sotme.

Megjithatë, në kapitullin e parë, autori bën një hyrje edhe për kohërat më të hershme të historisë së Krishterimit dhe të asaj kishtare në trojet shqiptare, duke u ndalur në momente të rëndësishme të këtyre periudhave, duke na dhënë një pasqyrë të përgjithshme të gjendjes dhe të organizimit kishtar në provincat e Prevalit dhe të Dioklesë. Shpresojmë që autori në një botim të dytë ta zgjerojë edhe ca këtë kapitull të historisë mesjetare kishtare në trojet shqiptare.

Kapitulli i dytë merret me situatat e Kishës gjatë pushtimit osman, duke i pasqyruar këto situata që nga shekulli XV e deri në shekullin XIX. Megjithatë, në këtë kapitull autori na paraqet, jo vetëm histori kishtare por edhe me disa ngjarje që kanë të bëjnë me situatën politike dhe sociale në veri të Shqipërisë, sidomos në zonat e Malëcisë së Madhe. Ja vlen të përmend këtu kryengritjet e fiseve veriore në shekujt 17-19, të cilat kanë lidhje qoftë me katolicizmin, qoftë edhe me historinë e kishës në ato trojet e këtyre fiseve.

Në kapitullin e tretë punimi ka si objekt islamizimin e shqiptarëve që ndodhë në masë në shekuj XVII-XVIII. Sigurisht për të pasqyruar përmasat e këtij fenomeni që preku pjesën dërrmuese të popullsisë shqiptare nevojitet që të paraqitet gjendja fetare e mëparshme dhe për këtë autori i kthehet pjesërisht Mesjetës, duke paraqitur në mënyrë të shkurtër, por koncize, histori dioqezash mesjetare të zhdukura, si p. sh. Drishti, Shasi, Baleci, apo Ulqini, etj. Po ashtu interesante janë të dhënat që autori jep për dioqezat e Shkodrës, Tivarit, Lezhës, Pultit, etj. për të cilat, ai, përveç të dhënave mbi

historinë e tyre mesjetare, jep edhe informacione interesante mbi vazhdimësinë e tyre gjatë shekullit të vështirë të XVI, që është shekulli i parë i pushtimit të gjatë osman dhe gjithashtu, ku vazhdoi edhe kthimi popullsisë së islamizëm që u intensifikua sidomos në shekullin e më vonë. Autori e pasqyron këtë proces me shifra për çdo dioqezë dhe, një burim i çmuar nga ku autori nxjerr shumë të dhëna, janë edhe relacionet, nga këto bien në sy relacioni i Imzot Marko Giorgës, dhe të Vincens Zmajeviqit, të cilave autori u kushton një hapësirë të veçantë. Ky kapitull i punimit është mjaft e gjerë dhe përfshin brenda tij edhe të dhëna në lidhje me dobësimin e Islamit në shekullin e 19, gjë që solli edhe një ripërtëritje të Kishës, ku bën pjesë edhe hapja dhe organizimi i shkollave katolike gjatë viteve 1872-1894.

Sikurse në Kryedioqezën e Shkodrës, ku më 1856, me ndërmjetësimin, por edhe me kërcënimin e Austrisë që i bënte pushtetit turk, u ndërtua seminari i parë, i cili u pagëzua me emrin “Kolegji Papnor Shqiptar”, dhe në dioqezat e tjera, ku ishin hapur po ashtu shkolla, edhe Kryedioqeza e Durrësit, e pa të nevojshme organizimin e shkollave shqipe, të cilat në fillim organizoheshin pranë famullive të ndryshme, më pas edhe në vende të tjera publike.

Në relacionin e Imzot, Raffaele D'Ambrosio, Arqipeshkëv i Durrësit, shihen përparime të bëra në këtë drejtim. Kryedioqeza, në varësi të saj, kishte 7 shkolla filllore: 5 mashkullore dhe 2 femërore pesëvjeçare. Shënohet se shkollat ishin të ngritura nga viti 1872-1894. Finacimet për to i mbante qeveria austriake e italiane. Në këto shkolla, ku mësonin fëmijë e të tri besimeve, mësimet zhvilloheshin në gjuhën shqipe, italiane dhe gjermane. Edhe pranë godinave të kishave, shkollat vazhdonin punën nën kujdesin e famullitarëve, duke i ushtruar të gjitha lëndët edukative. Hapje të shkollave kemi edhe në vitet në vazhdim, në kohën e imzot Prekë Bardhit (Biancu) dhe imzot Pjetër Gjures, të cilat vazhuan ta kryenin misionin e tyre, deri në mbylljen përfundimtare të të gjitha shkollave katolike në Shqipëri, në vitin 1933, kur në mënyrë arbitrare, këtë veprim e bëri mbreti, Ahmet Zogu. Siç sihet pra hapjes së shkollave nga ana e Kishës, autori i kushton një vëmendje të veçantë.

Kapitulli i katërt dhe i fundit, është më i madhi i punimit dhe trajton në afërsisht 181 faqe historinë e Kishës në shekullin XX. Bien në sy në mënyrë të veçantë trajtimet që i bën autori përballejeve të Kishës Katolike me sfidat që i nxorri Zogu asaj dhe shkollave katolike në veçanti. Po ashtu një hapësirë mjaft të gjerë autori u kushton edhe ngjarjeve gjatë diktaturës komuniste, kur Kisha mori edhe një herë gotitje të rënda, dhe përjetoi një persekutim që nga vitet e para të diktaturës komuniste e deri në ditët e fundit të saj. Në mënyrë

900 vite të tjera, gati dhjetë shekuj burg. Vetëm ata, të pushkatuarit, bënë rreth 300 muaj, rreth 25 vjet tortura e hetuesi. Afro 70 muaj, 6 vjet hetuesi e tmerr, bënë ata tjerët, të mbyturit ndër tortura”.

Perse i përket mbylljeve të institucioneve fetare sipas një statistike, në vitin 1967 u mbyllën gjithsejtë 2169 objekte fetare: kisha xhami, manastire e institucione të tjera fetare”

Pjesët e fundit autori ia kushton ringjalljes së kishës Katolike në Shqipëri, nga viti 1990 deri në ditët të sotme. Në fund dua të ndalem edhe në



konçize dhe sistematike autori paraqet persektimet e klerit deri në vrasje dhe në fund bën edhe një bilanc si në vijim ku përfshihen edhe persekutimet gjate të ashtuquajturit revolucionit kulturor. Po citoj, “Krahas shkatërrimeve e konfiskimeve të objekteve fetare, shënohet se shumë pak klerik kishin mbetur ende gjallë. Sipas një statistike mësohet se gjatë periudhës (1945-1980) që kur regjimi komunist erdhi në fuqi, kishin vdekur nëpër burgjet e shtetit, 2 argjipeshkvi, 5 ipeshkvi, 1 abat, 65 priftërinj dioqezën, 33 françeskan, 14 jezuit, 10 seminarist dhe 8 murgesha. Ishin rreth 200 klerikë që kishin kryer 500 vjet studime në 25 universitete të Evropës e do të bënin mjerisht tani, në Shqipërinë e tyre edhe mbi

burimet dhe në literaturën që ka përdorur autori për krijimin e kësaj monografie. Spektri është shumë i gjerë. Lista e arkivave, në të cilat autori ka hulumtuar është mjaft e pasur, bie në sy sidomos Arkivi Historik i Kongregacionit të Propaganda Fide. Literatura e përdorur është e shumtë. Në njëzet faqet e kësaj e bibliografisë së punimit janë të paraqitur tituj në gjuhëve të ndryshme, si në Latinisht, Italisht, Anglisht, Gjermanisht, Shqip, Kroatisht e Serbisht, etj. Së fundi mund të them që autori ka sjellë për lexuesin dhe studiuesin shqiptar një punim që të munguar të historisë e Kishës Katolike në Trojet Shqiptare.

Fatmira NIKOLLI

Tiranë

**KUVENDI I TROSHANIT
GJURMËT E 1600-ËS E SHKOLLA E 1800-ËS.
NJË MONUMENT PËR FISHTËN**

Diku muret në gri të hershme e matanë e verdha e bojës së kohëve të mbrame, shfaqen pas një rrethimi me kangjella. Kishë, Kuvend e shkollë, në Troshan hodhën hapin e parë të shkollimit, emra në zë të kulturës shqiptare. Përmendim Shtjefën Gjeçovin (etnolog, arkeolog), Justin Rrotën (gjuhëtar dhe shkrimtar), Viktor Volajn (letrar dhe sekretar i At Fishtës), Daniel Gjeçajn (letrar), Vinçenc Prennushin, (poet, shkrimtar, përkthyes), Anton Harapin (romancier, filozof), At Martin Gjokën (kompozitor), Marin Sirdanin (historian), Benardin Palajn (folklorist); Gjon Shllakun (filozof e shkrimtar); Donat Kurtin (gjuhëtar e folklorist), e pos tyre edhe at Gjergj Fishtën (shtëpia e lindjes së tij, ndodhet 1 kilometër larg). Për të gjitha këto arsye, objektit, themelet e të cilit u hodhën më 1850-ën, në mbledhjen e fundit të Këshillit Kombëtar të Restaurimit iu dha statusi "Monument Kulturë". Kuvendi i Troshanit (në Lezhë) është i restauruar nga Provinca Françeskane Shqiptare. Ai zotëron ambiente të brendshme të bollshme dhe shumë të përshtatshme për krijimin e një muzeu përkujtimor në nder të të gjitha figurave të ndritura françeskane shqiptare, duke u bërë kështu edhe një mundësi e shkëlqyer për turizëm kulturor.

"Në nderim të At Gjergj Fishtës, dhe në emër të mbrojtjes së Trashëgimisë Kulturore, në mbledhjen e fundit të Këshillit Kombëtar të Restaurimit, iu dha statusi 'Monument Kulturë' Kuvendit të Troshanit, vendi ideal për të nderuar jo vetëm Gjergj Fishtën, atje ku ai jetoi, u shkollua dhe shërbeu, por për të përjetësuar nderimin për të gjitha këto mendje të ndritura jo vetëm për katolicizmin shqiptar, por edhe për kulturën dhe letrat shqipe", shkroi ministrja e Kulturës, Mirela Kumbaro në "Facebook". Një muaj më parë, ajo vizitoi Kuvendin bashkë me famullitarin e Kuklit, Dom Nikë Ukgjinin. Jo larg fshatit Fishtë, gjendet Kuvendi i Troshanit, ku etërit françeskanë në vitin 1639 erdhën në shkrepat e këtij fshati të Zadrimesë duke ngritur një Kishë dhe një shtëpi të të varfërve. "Më vonë, etërit françeskanë ishin ulur në vendin e tanishëm, ku me ndihmën e Austro-

Hungarisë ndërtuan Kishën dhe Kuvendin në vitin 1857. Në vitin 1880, u dha leja e hapjes së kolegjit (shkollës) në këtë Kuvend, që u inaugurua më 14 prill 1882 nga misionarët: At Mariano Pizzochini, prej Palmanova, (Udine) dhe At Gian Piero Ferrari, prej Bergamo", shkruante Kumbaro atë kohë, sipas rrëfimeve të Dom Nikë Ukgjinit.

Drejtori i kësaj shkolle, nga viti 1883-1893 ishte At Lovro Mihaçeviq, nga Bosnja, i cili ka shkruar dy vepra të rëndësishme për shqiptarët, në kroatisht dhe gjermanisht: "Nëpër Shqipëri", 1911 dhe "Shënime nga historia e Shqipërisë", 1912. Duke qenë të nxitur nga porositja papnore për edukimin e brezave të rinj, nga ky Kolegj, u nxor pas pesë viteve shkollim, gjenerata e parë, prej gjashtë nxënësve shqiptarë, të cilët në vitin 1886, qenë dërguar për studime të mëtejshme në Bosnjë, për t'u bërë meshtarë të urdhrit françeskan. Dallëndyshtet e para që fluturuan nga Shkodra për në rishtari (noviciat) në Guçja Gora, afër qytetit të Travnikut (Bosnjë), sipas dok. 573, dt. 15 tetor 1886, ishin: Gjergj Fishta me emrin e pagëzimit Jozef; At Anton Nënshati; At Jozef Blinishti, At Pjetër Gjadri; At Lorenc Mitrovic (Mazreku); At Engjëll Paliç. Kolegji (shkolla) i Troshanit me pak shkëputje, qëndroi i hapur deri në vitin 1921, për të vazhduar më pas duke kryer funksionin e Kuvendit për edukimin e rishtarëve (novicie) deri në vitin 1945. Në Troshan të Zadrimesë, mësuesi i Gjergj Fishtës, Shtjefën Gjeçovit, Pashko Bardhit etj. ishte poeti italo-arbëresh Leonardo De Martino (1830-1823), i cili e ngriti poezinë shqiptare në majat më të larta me botimin "Harpa e një Arbëreshi" në vitin 1881, në shqip dhe italisht etj. Prifti i famullisë, At Sokol Pepushaj flet për tavanin origjinal të kishës, ballkonin e korit (cantorium) me të gjitha gdhendjet autentike, që kërkonte ndërhyrje për mbrojtje, Kuvendin e motrave, veprimtaritë edukuese e kulturore, gjurmët e themeleve të shkollës së Gjergj Fishtës e të kulmeve të saj në krahun e majtë të kishës, të cunguar në vitet e errëta kur besimin diktatura e pati dënuar me vdekje, pa e vrarë dot kurrë.

Marrë nga:

Gazeta Shqiptare, 8 Qershor 2017

PERSONI I PARË I CILI QITI NË DRITË EMRIN SHQIPTARËVE

Klaudius Ptolemy (Ptolemeu), astrolog, muzikolog, matematicien, shkrimtar dhe gjeograf.

Më 23 korrik të vitit 90 në Aleksandri, provincë romake, Egjipt – lindi Klaudius Ptolemy (Ptolemeu), astrolog, muzikolog, matematicien, shkrimtar dhe gjeograf.

Prejardhja e saktë e tij nuk dihet. Disa thonë se ishte romak, të tjerë thonë, helen, por nisur nga emri 'Ptolemy', ai mund të ketë qenë me prejardhje nga Ptolemajtë e periudhës së Aleksandrit të Madh.

Ptolemeu shkroi shumë libra, traktate shkencore, studime, por shqiptarët e përmendin atë kryesisht për Gjeografinë e tij (rreth vitit 130), ku Ptolemeu sjell për herë të parë të dokumentuar emri 'Albanian' me kryeqytet Albanopolis, sa kalon Durrësin, diku midis Tiranës dhe Krujës. (kjo faqe në librin e tij thuhet se ka humbur a është grisur, por të dhënat citohen nga burime të asaj kohe).

Dhe kështu fillon rrugëtimi historik i një emri; 'Albania' e "Albanoi"u popullarizua nga Anna Komnena (1083-1146), bija e perandorit bizantin Aleks i parë, e cila shkroi në historinë e saj të famshme Alekseida, se njerëzit që banonin në zonën përtej Durrësit e quanin veten 'Arbanез'. Në fillim të shekullit XII normanët në epikën e tyre në frëngjisht, 'Këngët e Rolandit' e quajtën 'Albania' rajonin nga Durrësi në Vlorë. Në shekullin XIV, ata që ikën në Greqi nga këto troje e quajtën veten në dialektin gjuhësor 'Arbanitë' – 'Arvanitë'. Në shekullin XV ata që ikën në Italinë jugore e quanin atdheun e tyre 'Arbana' dhe veten 'Arbëreshë'. Gjon Buzuku, një nga shkrimtarët e parë shqiptarë të shekullin XVI, i referohej vendit të vet 'Arbën'.





Madje Buzuku ishte i pari që e quajti gjuhën e tij 'Shqip'. Ndërkohë bota vazhdon të përdorë emrin e vjetër 'Albania' (ndikuar nga Ptolemeu) dhe 'Albanian' për gjuhën që flitet, ndërsa vendasit mbështeten në fjalën 'shqip' dhe 'Shqipëri' dhe 'Shqiptarë' e quajnë veten e tyre.

Gjeografia nga Ptolemeu:

Ptolemeu është përgjegjës për disa nga tekstet e historisë më të rëndësishme në astronomi dhe hartës. "Gjeografia", udhëzuesi i tij për kartografinë, konsiderohet si përpjekja e parë e vërtetë në botë për krijimin e një harte të botës.

Ndërkohë që ideja e Ptolemeut mbi botën mund të mos duket si globi modern ku ne kemi qasje sot, mbetet sërish një punë mbresëlënëse për shekullin e 2-të. Shumë nga teknikat moderne të hartës që përdorim sot ende varen nga risitë e bëra nga Ptolemeu në trajtimin e portretit të tij.





Papa Françesku

EMRI ZOTIT ËSHTË
MËSHIRË

Arqipeshkvia Shkodër - Pult
Shkodër, 2017



Eugjen Merlika

Përsiatje...

Omsca-1
Tiranë 2016



Frrok Kristaj

PJETËR BOGDANI

Shoqata e Shkrimtarëve
Shtjefën Gjeçovi
Zym, 2015

KUMBONA E SË DIELËS

revistë fetaro-kulturore dymujore
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult

Tirazhi: 1000 kopje

Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)

Parapagimi vjetor 600 lekë
(Evropë: 12 Euro)

e-mail: n_ukgjini@yahoo.it

Web page: www.kishakatolikeshkoder.com

Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,
Sheshi "Gjon Pali II"

Shtypur në Entin Botues "Gjergj Fishta" - Lezhë